




ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 16, Korrik 2015

ISSN 2225-2959



BANKINGU HIJE NË SHQIPËRI

Shoqata Shqiptare e Bankave boton: Raportin Vjetor 2014 & Raportin CSR 2014: “Bankat për Shoqërinë”



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Për t'u njohur më mirë me botimet e AAB, mund të
shkoni në internet në adresën www.aab.al



ANËTARËT E AAB





BANKINGU HIJE NË SHQIPËRI

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. **Bankieri** i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE
Rr. Ibrahim Rugova,
SKY TOWER, 9/3, Tiranë
Tel: +355 4 2280371/2
Fax: +355 4 2280 359
E-mail: bankieri@aab-al.org;
www.aab.al

Bankieri

No.16, Korrik 2015
Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Editorial

Bankingu hije në Shqipëri
E shkuara, e tashmja dhe e ardhmja!
Elvin MEKA

Tema e ditës

Bankingu hije dhe
mundësitë e sektorit bankar në Shqipëri
Athanasios PALOUDIS

Pak dritë mbi bankungun hije
Teuta BALETA, Rinald GURI

Sistemi Bankar

Ndryshimi në kontrollin e rrezikut të
besueshmërisë, një lëvizje në drejtimin e duhur
Arjan KADAREJA

Përlogaritja e rrezikut nëpërmjet modeleve të
brendshme, një mundësi për t'u konsideruar
Altin KADAREJA

Forumi i Ekspertëve

Konsiderata mbi vlerësimin
e pasurive të paluajtshme në kushtet e sotme
Anton LEZHJA

Auditimi i brendshëm.
Roli i tij në shmangien e mashtrimeve bankare
Stavri PASHKO

Këndi i Ekonomistit

Bankat dhe sistemi financiar
përballë fenomenit të pastrimit të parave
Adrian CIVICI

Përgjegjshmëria Sociale

Veprimtaritë e bankave

Zona e Sigurisë së Informacionit

Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim
(SIRK) në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave
Blerta KOÇI

Rëndësia e sigurisë kibernetike
dhe roli i ALCIRT-it
Rovena BAHITI

Auditori Financiar

Zbatimi i artit dhe shkencës së menaxhimit
të projekteve në biznesin e sotëm
Bianca DURO

ICC Academy

AAB Aktivitete

REDAKSIA:

Elvin Meka
Kryeredaktor
Eftali Peçi
Koordinatorë Produksioni
Junida Tafaj (Katroshti)
Bashkëpunëtore
Andis Rado
Fotograf
Design & Layout: PIK Creativ

Printed by: Gentgraf

BORDI EDITORIAL:

Christian CANACARIS
Kryetar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Raiffeisen
Bank Shqipëri

Gazmend KADRIU
Drejtor i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm dhe Anëtar i
Bordit të Union Bank

Periklis DROUGKAS
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Alpha Bank
Albania

Seyhan PENCABLIGIL
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Banka
Kombëtare Tregtare

Frédéric BLANC
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Societe
Generale Shqipëri

Bozhidar TODOROV
Anëtar i Bordit Drejtues
të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm i Fibank
Shqipëri

Endrita XHAFERAJ
Sekretare e Përgjithshme,
Shoqata Shqiptare e
Bankave

Hysen ÇELA
Kryetar i Institutit të
Ekspertëve Kontabël të
Autorizuar

Adrian CIVICI
President i Universitetit
European të Tiranës

Spiro BRUMBULLI
Drejtor i kabinetit të
Ministrit të Financave

Enkeleda SHEHI
Drejtoreshë Ekzekutive e
Autoritetit të Mbikqyrjes
Financiare



nga Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹
Kryeredaktor

Banking u hije ka qenë një prej frazave më të lakuara në sistemin financiar botëror, mes profesionistëve të tregut financiar dhe brenda qarqeve akademike, sidomos pas shpërthimit të krizës së fundit financiare të 2007-2008-ës, nisur dhe nga roli i veçantë, që sistemi i "bankingut hije" luajti në gjenerimin e kësaj krize. Termi "banking hije", i skalitur nga Z. Paul McCulley, ekonomisti amerikan dhe ish-drejtori i përgjithshëm i PIMCO, një nga firmat e mirënjohura për menaxhimin global të investimeve, përfshin shërbimet financiare dhe huadhënies ndaj klientëve, qoftë biznese apo individë, nëpërmjet kanaleve jo-tradicionale dhe jo-bankare, që ofrohen nga ente të cilat nuk janë subjekt i mbikëqyrjes, sikundër dhe veprimtaria financiare e ndërmjetësve të rregulluar, që nuk është subjekt i mbikëqyrjes dhe rregullimit. Megjithatë, ky përkufizim nuk është shterues, pasi sipas revistës GLOBAL FINANCE: "Bordi i Stabilitetit Financiar (FSB) jep përkufizim shumë të gjerë të bankingut hije, duke përfshirë këtu të gjitha llojet e ndërmjetësimit financiar jo-bankar", ndërkohë

Bankingu hije në Shqipëri

E shkuara, e tashmja dhe e ardhmja!

Bankingu hije nuk është "macja e zezë" për sistemin financiar, përkundrazi, ai mund të ndihmojë rritjen ekonomike të vendit, por ai shoqërohet, në mënyrë të pashmangshme, edhe me rreziqe.

që e përkufizon atë si Universi Monitorues i Ndërmjetësimit Financiar e Jo-bankë (MUN-FI).

Në rastin e Shqipërisë, bankingu hije nuk përbën një fenomen të ri, edhe pse "bankingu hije" shqiptar, ka qenë në një formë tejet rudimentare dhe nuk kishte pothuajse asgjë të krahasueshme me përkufizimin standard të tij. Megjithatë, të gjithë i dimë shumë mirë pasojat dhe efektet e një veprimtarie të tillë, gjatë dekadës së fundit të shekullit të kaluar. Tani ajo i takon të shkuarës dhe për fat të mirë ai nuk ishte i ndërlidhur me sistemin bankar. Për sa i përket të tashmes, situata është shumë më e ndryshme dhe pozitive, në çdo aspekt, si në atë rregullator, operacional, të qasjes publike dhe institucionale ndaj rrezikut dhe menaxhimit përkatës të tij, etj. Nga ana tjetër, ajo çka shohim aktualisht është një rritje e huadhënies dhe huamarrjes informale dhe zëvendësimi i qetë i depozitave bankare me alternativa të tjera, që vijnë nga skemat e investimeve kolektive, një zgjedhje pragmatike kjo për individët, të cilët natyrshëm janë në kërkim të kthimeve më të larta, në një mjedis me norma interesi vazhdimisht të ulëta dhe shumë të ulëta. Ajo çka është specifike për një vend si Shqipëria, është se bankingu hije modern dhe standard po zhvillohet në mungesë totale të çdo forme të organizuar të tregut të letrave me vlerë, që do t'u mundësonte rregullatorëve mbledhjen e më shumë të dhënave dhe informacioneve lidhur me të, pa përmendur këtu faktin e

mundësive që u krijohen këtyre për ta monitoruar, mbikëqyrur, rregulluar dhe disiplinuar atë, duke minimizuar dhe izoluar natyrën sistemike të rreziqeve, që shkakton dhe gjeneron një veprimtari të tillë. E ardhmja mund të sjellë sfida të shumta, jo vetëm për rregullatorët e sistemit financiar shqiptar, por edhe për bankat tregtare, nëse kihet parasysh: natyra sfiduese dhe rritja e qëndrueshme e bankingut hije, në një kohë kur bankat tregtare do të jetë shumë më pak të interesuara të japin hua afatgjata, për arsye rregullatore, procesi i integritetit të Shqipërisë në BE, si dhe revolucioni dixhital dhe teknologjitë e reja, veçanërisht të dhënave masive dhe inteligjenca e biznesit, të cilat po e riorganizojnë tërësisht peizazhin financiar, në rrafsh global.

Pa diskutim që, bankingu hije nuk është "macja e zezë" për sistemin financiar, përkundrazi, ai mund të ndihmojë rritjen ekonomike të vendit, por ai shoqërohet, në mënyrë të pashmangshme, edhe me rreziqe. Kjo është arsyeja pse rregullatorët e sistemit dhe tregjeve financiare duhet të ketë parasysh thënien e famshme të Desiderius Erasmus, humanistit të njohur holandez, se: "*Është më mirë të parandalosh sesa të shërosh!!!*"

¹ Zv.Dekan & Përgjegjës i Departamentit të Financës, UET



nga **Z. Athanasios PALOUDIS**,

Drejtor i Rrjetit të Degëve
& Divizionit të SME-ve
TIRANA BANK

Shumë njerëz marrin gjatë gjithë kohës hua e kjo për një numër të pacaktuar arsyesh. Ata mund të dëshirojnë të blejnë një shtëpi apo truall, kërkojnë të investojnë në arsimim apo në një biznes, në arsimimin e fëmijëve të tyre, ose për të mbuluar shpenzimet e një urgjence shëndetësore. Kur paratë nuk dalin për financimin e shpenzimeve të tilla, ata fillojnë t'i kërkojnë ato te dikush tjetër, te banka, te një mik ose familjar, ose te një huadhënës informal. Në disa vende të botës shumë njerëz mund të përdorin kartat e kreditit, në vend të huave standarde. Përgjithësisht, sa herë që nuk përdoren produktet e bankingut tregtar, thuhet se në një mënyrë apo tjetër, shihet veprimtaria e bankingut hije.

Termi "banking hije" i atribuohet ekonomistit dhe menaxherit të fondit të investimeve të tregut të parasë, Z.

Bankingu hije dhe mundësitë e sektorit bankar në Shqipëri

“ Njëpërmjet qasjes dhe qëndrimit të duhur, të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri mund të punojnë më shumë, me qëllim sigurimin e përparësive dhe institucionalizimin e tregut të parasë në Shqipëri, pasi në afat të gjatë kjo do e bëjë më të lehtë kontrollin e ekonomisë së vendit, axhustimin e normave të interesit dhe gjithashtu kontrollin e ofertës së parasë. ”

Paul McCulley, i cili në vitin 2007 e përdori atë për të përshkruar një segment të madh të ndërmjetësimit financiar që realizohej jashtë bilanceve të bankave tregtare dhe institucioneve të tjera depozituese, të rregulluara sipas legjislacionit bankar. Bankat hije përkufizohen si ndërmjetëse financiare që kryejnë funksionet e bankingut, por që nuk kanë qasje në likuiditetin e bankës qendrore, apo në skemat publike të garancive për huadhënien.

Në kuptimin e gjerë të fjalës, sistemi i bankingut hije mund të përshkruhet si ndërmjetësim për huadhënien, që përfshin subjekte dhe veprimtari që kryhen jashtë sistemit të rregullt bankar. Ndërmjetësimi për huadhënien përmes kanaleve jobankare mund të ketë përparësi të rëndësishme dhe kontribuon në financimin e ekonomisë reale; gjithsesi, kanale të tilla mund të bëhen edhe një burim i rrezikut sistematik, veçanërisht kur ato strukturohen për të kryer funksione të ngjashme bankare (p.sh. transformimi i afateve të maturimi dhe likuiditetit, dhe përdorimin e levës financiare) dhe kur ndërlihdja e tyre me sistemin e

rregullt bankar është e fortë. Kështu, monitorimi i duhur i bankingut hije ndihmon në minimizimin e ndërtimit të rreziqeve të tilla sistemike.

Emëruesi i përbashkët me këtë rast është që këto veprimtari lulëzojnë jashtë sistemit të rregullt bankar dhe shpesh përtej kontrollit të rregulla-

“ Në vendet në zhvillim, sektori i bankingut hije ofron lubrifikantin që siguron funksionimin pa probleme të ekonomisë. Bizneset e vogla marrin huat për të cilat kanë nevojë; kursimtarët kryejnë investime që sigurojnë një kthim më të lartë sesa inflacioni dhe në ekonomitë me sisteme të pazhvilluara financiare, bankingu hije mbush një vakum brenda sistemit. Ky përbën gjithashtu edhe rastin e Shqipërisë. ”

torëve dhe politikës monetare. Së bashku, ata tregojnë se sa e vështirë është kufizimi i huadhënies së rrezikshme, pa shkaktuar dëme.

Për shembull, në vendet në zhvillim, sektori i bankingu hije ofron lubrifikantin që siguron funksionimin pa probleme të ekonomisë. Bizneset e vogla marrin huat për të cilat kanë nevojë; kursimtarët kryejnë investime që sigurojnë një kthim më të lartë sesa inflacioni dhe në ekonomitë me sisteme të pazhvilluara financiare, bankingu hije mbush një vakum brenda sistemit. Ky përbën gjithashtu edhe rastin e Shqipërisë, pasi ajo nuk mund të bëjë përjashtim nga këto praktika, apo sjellje financiare.

Së fundi, anketa e kryer nga Gallup International dhe Banka Botërore arrin në përfundimin se, 56% e të rriturve shqiptarë kanë përdorur gjatë 2013-2014 kanalet alternative, jashtë atyre bankare, për të marrë hua; një përqindje kjo shumë e lartë edhe po të krahasohet me rajonin, për të cilin kjo shifër ishte rreth 36%.

Sondazhi tregon se 43% e shqiptarëve kanë marrë hua për çështje urgjencash nga të afërmit e tyre, 10% nga punëdhënësit e tyre dhe 25% kanë përdorur kursimet e tyre. Anketa tregon gjithashtu se, 25% e shqiptarëve i përdorën fondet e huazuara për të mbuluar urgjencat shëndetësore, 12% për arsimim, 9% për të blerë një shtëpi të re dhe 4% për të investuar në fillimin e një biznesi.

Anketa tregoi se, në Shqipëri, ndryshe nga vendet e tjera të zhvilluara ose të OECD-së, financimi gjatë dy viteve të fundit nuk është ofruar nga bankat dhe sektori financiar. Megjithatë, mund të thuhet se bankingu hije mund të shihet si një sistem paralel - pra një sistem që është plotësues, por jo zëvendësues për bankingu tradicional. Në ekonomi të tilla qëndron dhe mundësia për të zgjeruar përfshirjen financiare të qytetarëve. Këto ndahen në dy kategori të mëdha: zgjerimi i numrit të llogarive të qytetarëve që nuk kanë qasje në shërbimet bankare dhe rritja e përdorimit të llogarive nga ata që tashmë e kanë një të tillë.

Sfida në çdo rast për sektorin privat është projektimi i produkteve të duhura financiare që përmbushin nevojat e atyre që nuk kanë qasje në shërbimet bankare, duke u dhënë mundësinë atyre të përdorin të paktën një llogari me aq lehtësi, komoditet dhe kosto të lirë, sa alternativat e tjera. Nëpërmjet një kuadri rregullator nxitës dhe inkurajues për zgjerimin e përdoruesve të llogarive bankare - nëpërmjet veprimeve të tilla si: licencimi i agentëve bankarë, kërkesat për dokumentacion të plotë dhe shumënivelësh të vepërimitarisë, ofrimi nga ana e bankave i llogarive bazë apo me kosto të ulët dhe lejimi i zhvillimit të teknologjive të reja, si: paraja elektronike - qeveritë jo vetëm mund të ndihmojnë në uljen e kostos së shërbimeve financiare, por



Sfida në çdo rast për sektorin privat është projektimi i produkteve të duhura financiare që përmbushin nevojat e atyre që nuk kanë qasje në shërbimet bankare, duke u dhënë mundësinë atyre të përdorin të paktën një llogari me aq lehtësi, komoditet dhe kosto të lirë, sa alternativat e tjera.



edhe të ndihmojnë në shkurtrimin e distancës midis institucioneve financiare, duke e bërë më efektiv, nga pikëpamja e kostos, procesin e hapjes së degëve të tyre në zonat më të largëta.

Një mundësi premtuese për zgjerimin e përfshirjes financiare të qytetarëve pa qasje në shërbimet bankare, është dixhitalizimi i pagesave, duke i kanalizuar pagesat në para të gatshme drejt llogarive. Zhvendosja drejt pagesave dixhitale ka shumë përfitime, si për dërguesit ashtu dhe për përfituesit. Kjo mund të përmirësojë eficiencën e kryerjes së pagesave, duke rritur shpejtësinë e tyre dhe duke ulur koston e disbursimit dhe arkëtimit të tyre. Gjithashtu, kjo mund të rrisë sigurinë

e pagesave, duke zvogëluar kështu mundësinë e krimeve që shoqëron ato, si dhe mund të rrisë transparencën e pagesave, duke ulur gjasat e “firove” mes dërguesit dhe pranuesit. Zhvendosja drejt pagesave dixhitale mund të sigurojnë gjithashtu një portë fillestare hyrjeje të rëndësishme në sistemin formal financiar, që mund të çojë në një rritje të ndjeshme të kursimeve dhe zëvendësimin e kursimeve informale me apo formale. Me pak fjalë, përfitimet e pagesave dixhitale shkojnë përtej konceptit të lehtësive dhe komoditetit të përdorimit. Nëse ofrohen në mënyrë eficiente dhe efektive, pagesat dixhitale mund të transformojë jetën financiare të personave që i përdorin ato.

Pagesat për shitjen e produkteve bujqësore ofrojnë një tjetër mundësi për rritjen e numrit të llogarive mes qytetarëve pa qasje në shërbimet bankare. Në përgjithësi, në ekonomitë e vendeve në zhvillim, rreth 23% e të rriturve - ose 440 milionë njerëz pa qasje në shërbime bankare - përfitojnë pagesa në parë të gatshme nga shitja e prodhimeve bujqësore. Shumë njerëz që përfitojnë pagesa nga shitja e produkteve bujqësore janë pjesë e një zinxhiri të caktuar vlerë në bujqësi. Kjo nënkupton që një aktor - p.sh. blerësi i një produkti bujqësor - mund të ketë një ndikim shumë të fortë mbi mënyrën se si përfitohen këto pagesa. Ashtu sikundër edhe në rastin e pagesës së pagave dhe transfertave nga sektori qeveritar, dixhitalizimi i pagesave për produktet bujqësore mund të kontribuojë në zgjerimin e shpejtë në numrit të llogarive.

Siç shihet, mundësitë që hapen përpara bankave për trajtimin dhe zgjidhjen e këtij problemi janë të shumta. Nëpërmjet qasjes dhe qëndrimit të duhur, të gjitha bankat që operojnë në Shqipëri, por dhe Tirana Bank në veçanti, mund të punojnë më shumë, me qëllim sigurimin e përparësive dhe institucionalizimin e tregut të parasë në Shqipëri, pasi në afat të gjatë kjo do e bëjë më të lehtë kontrollin e ekonomisë së vendit, rregullimin e normave të interesit dhe gjithashtu kontrollin e ofertës së parasë.

Zj. Teuta BALETA

Këshilltare

Z. Rinald GURI

Drejtor i Departamentit të
Kërkimeve, IT dhe Statistikës

Pak dritë mbi bankingun hije



Veprimtaria e bankingut hije jo domosdoshmërisht është e rrezikshme për qëndrueshmërinë e sistemit financiar në tërësi. Si çdo veprimtari tjetër financiare, ajo ka përparësitë e saj dhe e ndihmon funksionimin e sistemit financiar, sidomos duke shtuar masën e likuiditetit që ofrohet në treg.



Kriza financiare botërore, që nisi në vitet 2007-2008, nuk konsiderohet si një krizë thjesht bankare. Një pjesë e rreziqeve, që më pas u materializuan në faktorë që shkaktuan apo rënduan këtë krizë, u "krijuan" dhe u "rritën" në veprimtari apo institucione financiare jobanka, për të cilat ka hyrë në përdorim termi "banka hije" apo "veprimtari bankare hije". Termi, pavarësisht se po gjen përdorim gjithnjë e më të gjerë, përmban paqartësi përse i takon konceptit të tij. Paqartësia rritet edhe për shkak të shqipërimet. Në mënyrë të natyrshme termi "banka/veprimtari hije" e kuptojmë si një institucion apo veprimtari të parregullt apo të paligjshme, që kryhet fshehurazi. Në fakt termi është përkthimi literal i termit në gjuhën angleze "shadow bank/banking". Në gjykimin tonë, fjala e gjuhës shqipe "hije" mbetet përkthimi më i saktë i mundshëm, krahasuar me përpjekje për të përdorur terma të tjerë, si p.sh.: sistem/veprimtari bankar(e) apo banka paralele, ose të parregulluara. Termi "hije" nënkupton se kemi të bëjmë me një organizëm (njësi/veprimtari), që nuk është bankë ose veprimtari bankare, por që i qëndron si apo në hije organizmit dhe veprimtarisë bankare.

Termi "hije" bëhet më kuptimplotë kur shqyrton përpjekjet për ta përkufizuar "bankën/veprimtarinë bankare hije" dhe këtu detyra vështrësohet. Termi i përdorur për herë të parë në vitin 2007 nga Paul McCaulley, është ende në proces përkufizimi. Konceptet bazohen në kuptime të gjera dhe të ngushta të fenomenit; ato formësohen bazuar në institucionet,

veprimtaritë apo rreziqet, duke na dhënë një gamë të tërë përkufizimesh. Autorë të ndryshëm e barazojnë termin me titullizimin, veprimtaritë bankare jotradicionale apo dhënie e huave nga ndërmjetësit financiarë jobanka. Të tjerë autorë e përkufizojnë si të gjitha veprimtaritë financiare, përveç veprimtarive bankare tradicionale, të cilat për t'u kryer kërkojnë një garanci të radhës së fundit, private apo publike. Përkufizime më të gjera e shtrijnë konceptin edhe në veprimtaritë e ngjashme me ato bankare, por që kryhen nga shoqëri financiare, që nuk rregullohen si bankat. Bernanke (prill 2012) përdori këtë përkufizim: "Veprimtaria bankare hije, siç përcaktohet zakonisht, përbëhet nga një grup i ndryshëm institucioneve dhe tregjesh të cilat, bashkërisht, kryejnë funksione të veprimtarisë bankare tradicionale, por këtë veprimtari e ushtrojnë jashtë ose në mënyra që kanë pak lidhje me sistemin tradicional të institucioneve depozita-pranuese, të rregulluara."

Në nëntor 2010, G20 në takimin e Sulit mori vendimin që të forconte rregullimin dhe mbikëqyrjen e bankave hije. Detyra për trajtimin e kësaj çështjeje iu ngarkua Këshillit për Qëndrueshmërinë Financiare (Financial Stability Board, FSB). Ky organizëm e përcaktoi veprimtarinë bankare hije si "sistemi i ndërmjetësit të kreditit, që formohet prej institucioneve dhe veprimtarive që vepron jashtë sistemit të rregullt bankar" (2011a). Në këtë kontekst është ndërtuar edhe përkufizimi i Komisionit Europian (Green Paper, mars 2012), por ai përcak-

ton edhe veprimtaritë në të cilat përfshihen ato, si: pranimi i fondeve që kanë tipare të ngjashme me depozitat, përfshirja në funksionet e transformimi të maturitetit dhe/ose likuiditetit, ndërmarrja e transferimit të rrezikut të kreditit dhe përdorimi i drejtpërdrejt ose i tërthortë i levës financiare, si dhe përfshirja në veprimtari, të natyrës që mund të shërbejnë si burime të rëndësishme financimesh për institucionet jobanka, ku përfshihen: titullizimi, transaksione të huadhënies së titullizuar dhe të marrëveshjeve të riblerjes. Qartësisht thelbi në përkufizime të ndryshme është i njëjtë: **veprimtaria kredituese**, që është një veprimtari tradicionale bankare, e cila zhvillohet në forma dhe nga institucione të tilla, që del jashtë sferës së veprimit të rregullimit bankar.

Përkufizimi i konceptit "veprimtari bankare apo bankë hije" është i lidhur ngushtësisht me të paktën tri aspekte: (i) përcaktimin e institucioneve, veprimtarive apo rreziqeve që trajtohen si të tilla; (ii) matjen e shtrirjes së saj; si dhe (iii) përcaktimin e masave reaguese nga rregullatorët. Veprimtaria e bankingut hije jo domosdoshmërisht është e rrezikshme për qëndrueshmërinë e sistemit financiar në tërësi. Si çdo veprimtari tjetër financiare, ajo ka përparësitë e saj dhe e ndihmon funksionimin e sistemit financiar, sidomos duke shtuar masën e likuiditetit që ofrohet në treg. Ajo mund të përbëjë një pjesë të dobishme të sistemit financiar, sepse kryen disa funksione, si: ofrimi i alternativave të kursimit/investimit ndaj depozitave bankare; kanalizimi me efikasitet i buri-

¹ Mendimet e shprehura në artikull janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të AMF-së.

meve drejt nevojave specifike, duke përfutur nga specializimi që ato kanë; ofrimi i financimeve alternative për ekonominë reale, kur bankat dhe kanalet tradicionale të tregjeve janë në vështirësi, si dhe diversifikimi i rreziqeve jashtë sistemit bankar.

Por bankingu hije shoqërohet dhe me një numër rreziqesh. Disa prej tyre mund të kenë natyrë sistematike, nisur edhe nga fakti që zhvillohen jashtë sferës së veprimit të rregullatorëve dhe kompleksiteti i tyre, ndërlikohet me sistemin bankar; shtrirja e tyre në sferën e veprimit të sistemeve të ndryshme rregullatore, apo e kapërcimit të kufijve të tregjeve të letrave me vlerë dhe të fondeve të investimeve, në kërkim të kthimeve më të larta. Disa prej këtyre rreziqeve janë: rreziku i panikut, përdorimi në masë të madhe dhe të fshehur i levës financiare, shmangia e rregullimit dhe arbitrimin rregullator, apo dhe efektet që dështimet e këtyre institucioneve përcjellin te sistemi bankar. Bankat hije ekspozohen ndaj të njëjtave rreziqeve financiare si bankat, por nuk janë të mbështetura me të njëjtin nivel rregullimi dhe mbikëqyrjeje si bankat. Disa prej bankave hije mbështeten në financime afatshkurtra, duke u ekspozuar ndaj rreziqeve të tërheqjeve masive dhe të menjëhershme nga klientët. Meqenëse ato nuk janë në sferën e veprimit të rregullimit të njëjtë me bankat, për rrjedhojë mund të përdorin në shkallë të lartë levën financiare, duke ofruar financime të garantuara me kolateral, e duke u shndërruar në rrezik sistematik. Shmangia e bankave hije nga rregullimi ose mbikëqyrja që zbatohet për bankat tradicionale, e transformon procesin tradicional të ndërmjetësimit të kreditit

në struktura ligjore të pavarura, por që ndërveprojnë me njëra-tjetrën. Ky ishte një rast tipik që luajti një rol të rëndësishëm në mbrujtjen e krizës financiare botërore, që filloi në vitet 2007-2008. Në këtë rast, veprimtaritë që anashkaluan rregullat kontabël dhe të kërkesave të kapitalit i transferuan rreziqet jashtë sferës së veprimit të mbikëqyrjes bankare. Në rastet kur këto institucione u përballën me vështirësi apo falimentime, efektet u përcollën lehtësisht në sistemin bankar. Zhvendosja e efekteve të dëmshme në sistemin bankar ndodhi nëpërmjet disa kanaleve; si huamarrja nga sistemi bankar apo detyrimet e kushtëzuara me ndodhjen e rrethanës për ofrim likuiditeti nga sistemi bankar, të tilla si: linja krediti apo likuiditeti, apo në rastet kur kemi një shitje masive aktivesh, të cilat sjellin pasojë mbi çmimet e aktiveve financiare apo reale.

Sikurse është shprehur Mark Carney, guvernatori i Bankës së Anglisë (2014): “veprimtaria bankare hije është e *stër-madhe, me rritje të shpejtë në disa forma dhe që kuptohet pak, është një mjet i fuqishëm për të punuar mirë, por që po u administrua pa kujdes, mund të shndërrohet në shpërthyesë*”. Sot veprimtaria bankare hije konsiderohet si kërcënim më i madh për ekonominë botërore. Për rrjedhojë, sfida që shtrihet përpara autoriteteve është që rreziqet e qenësishme të bankave hije të trajtohen në mënyrë të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Nëse i referohemi rastit të Shqipërisë mund të arsyetojmë se sistemi financiar jo i sofistikuar krijon pak terren për zhvillimin e veprimtarisë bankare hije, por sjellje të tilla kanë filluar të vërehen (shih

tabelën) dhe mund të shfaqin dinamika të shpejta zhvillimi.

Ajo çka mund të bëjnë autoritetet është të angazhohen në studimin e fenomeneve, të cilat mund të jenë të thelbveprimtari bankare hije. Hapi i parë është mbledhja e më shumë informacioneve mbi fenomenet që zhvillohen në tregjet financiare në vend dhe identifikimi i atyre njësive/veprimtarive që i përafrohen kësaj veprimtarie. Së dyti, ka nevojë të përmirësohet baza e të dhënave dhe e shkëmbimit të tyre ndërmjet rregullatorëve të fushës financiare, për të kuptuar shtrirjen dhe ndërveprimin e fenomeneve bankare hije, si dhe ekspozimin që kanë segmente të ndryshme të tregut financiar kundrejt tyre. Autoritetet kanë mundësi që, bazuar në gjetjet e fazës studimore, të vendosin nëse do të duhet të zgjerohet fusha e veprimit për raportimin dhe rregullimin e veprimtarisë bankare hije dhe deri në ç’masë, apo duhet kaluar në veprime pak më të ashpra, për të frenuar zgjerimin veprimtarisë bankare hije. Së treti, nisur nga shkalla e kompleksitetit që ka veprimtaria bankare hije, është e rëndësishme që kërkesat ligjore/rregullatore për ndërveprimin e institucioneve financiare me klientët të forcohen në drejtim të regjimit të transparencës. Së fundi, detyra nuk i përket një rregullatori të vetëm, por do të kërkojë ndjekjen e një metode mbikëqyrëse të bashkërenduar ndërmjet rregullatorëve, për të mbikëqyruar dinamikën e zhvillimit të veprimtarisë bankare, me qëllim që ky fenomen t’i shërbëjë diversifikimit të sistemit financiar, dhe jo akumulimit të tepërt të rreziqeve, si dhe shndërrimit të tyre në rreziqe sistematike.

Sjellja e veprimtarisë bankare hije	Shfaqja e sjelljes së veprimtarisë bankare hije në Shqipëri
Përdorimi i levës financiare	Kjo formë sjelljeje në fazën aktuale të zhvillimit të sistemit financiar nuk vërehet, për shkak se tregtimi i instrumenteve financiare të borxhit nuk është i zhvilluar mjaftueshëm.
Transferimi i rrezikut të kredisë	Kjo formë sjelljeje në fazën aktuale të zhvillimit të sistemit financiar vërehet në një masë të izoluar, për shkak se fenomeni i titullimit nuk ka përhapje, por ka forma të produkteve të garantimit të kredive të lëshuara nga sipërmarrjet e sigurimeve. Zhvillimi i tregut të sigurimeve përtej produkteve tradicionale të sigurimeve të detyrueshme mund të sjellë zhvillim të shpejtë të fenomenit. Kuptohet që rigjallërimi i kreditit bankar krijon kushte për përforcimin e kësaj sjelljeje.
Transformimi i maturitetit	Kjo formë sjelljeje në fazën aktuale të zhvillimit të sistemit financiar ka filluar të vërehet, si rrjedhojë e zhvillimit të shpejtë të tregut të fondeve të investimit.
Transformimi i likuiditetit	Kjo formë sjelljeje në fazën aktuale të zhvillimit të sistemit financiar mund të themi se ka filluar të vërehet, por jo në formën tradicionale të saj. Kjo sjellje më tepër shfaqet si rrjedhojë e mungesës së zhvillimit të tregjeve dytësore në vend.
Mbledhja e depozitave	Kjo formë sjelljeje në fazën aktuale të zhvillimit të sistemit financiar nuk vërehet, për shkak se një sjellje e tillë është tipike për fondet e investimit të tregut të parasë (MMF) ose fondet e obligacioneve, që sillen si MMF-të. Në Shqipëri, nuk janë të zhvilluar as instrumentet e tregut të parasë dhe as fondet që investojnë ekskluzivisht ose në masën të paktën 50% të portofolit në të tilla instrumente, në tregjet vendase, apo të huaja. Por mundësia është që mjedisi të ndryshojë shpejt dhe kjo sjellje të bëhet e pranishme.

Super Kredi

Shijojeni qetësisht verën

Merreni tani, paguajeni pas 3 muajsh



Deri në 7 vjet dhe 1,000,000 lekë



4 22 66 288 | www.bkt.com.al



nga **Z. Arjan KADAREJA, PhD**,
Pedagog
Departamenti i Administrim Biznesit
INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË
(CIT)

Mbetet i mirënjohur fakti që, nëse i mbajmë të gjitha të tjerat konstante, sa më të larta të jenë normat e interesit të premtuara kontraktualisht, aq më të larta do të jenë kthimet e pritshme nga huat bankare. Gjithsesi, kjo është vetëm njëra anë, pasi gjërat e tjera nuk kanë pse të jenë konstante. Një nga gjërat e tjera është dhe mundësia e ripagimit të huas, e cila zvogëlohet me rritjen e normave të interesit të huas, të premtuara kontraktualisht. Kjo nënkupton se, përtej një niveli të caktuar, rritja e normave të interesit të huas lidhet me kthime të pritshme më të ulta. Në vijim, do përpiqem të argumentoj se ka ndodhur një ndryshim në strategjinë e bankave për menaxhimin e rrezikut të besueshmërisë (kredisë) dhe, më e rëndësishmja, kjo strategji e re po jep rezultate.

NJË HISTORI E FRESKËT

Pas krijimit të sektorit bankar privat shqiptar, strategjia e të menaxhimit të rrezikut të besueshmërisë nëpërmjet

Ndryshimi në kontrollin e rrezikut të besueshmërisë, një lëvizje në drejtimin e duhur

Bankat po përdorin një strategji të re "me këmbë në tokë", për kontrollin e rrezikut të besueshmërisë. Kjo nënkupton më pak diskriminim përmes normës së interesit dhe më shumë racionim të huas.

standardeve të lehtësuara të kreditit dhe normave relativisht të larta të interesit të huas prodhuan, deri në fund të vitit 2008, një bum huadhënieje dhe fitimesh të larta për bankat. Megjithatë, siç tregohet dhe në Grafikon 2, bumi fillestar u pasua nga një "shpërthim" i huave me probleme (NPL) dhe fitimeve (ROE) afër zeros, në vitin 2011. Përveç faktorëve të mirënjohur të mungesës së përvojës në menaxhimin e rrezikut të besueshmërisë, sjelljes agresive të disa bankave për të rritur pjesën e tyre të tregut dhe mungesës së cilësisë së mbikëqyrjes nga ana e bankës qendrore, mendoj se ka dhe një tjetër faktor, i cili i përkeqësoi më tej gjërat. Konkretisht, ky faktor lidhet qartësisht me strategjinë e rrezikut të besueshmërisë, të bazuar kryesisht në diskriminimin përmes normës së interesit, sesa në një kombinim të kufizimeve sasiore dhe diskriminimit përmes normës së interesit. Megjithatë, disa fakte të fundit sugjerojnë se bankat mund të jenë zhvendosur drejt strategjisë e dytë.

PAK TEORI

Në nivel individësh (shitjeve me pakicë) një bankë e kontrollon rrezikun e besueshmërisë kryesisht nëpërmjet racionimit të huas, në vend të përdorimit të një game të caktuar normash interesi apo çmimesh. Individët që marrin hua kanë më shumë gjasa të përzgjidhen ose të kufizohen nëpërmjet kufizimeve sasiore që vendosen mbi huat, sesa

nëpërmjet ndryshimeve në çmime apo në norma interesi.


Gjithsesi, kontrolli optimal i rrezikut të besueshmërisë është disi i ndryshëm për huat për biznes. Mbetet një fakt i mirënjohur se, përtej një niveli të caktuar të normave të interesit, ekziston një marrëdhënie e anasjelltë ndërmjet kthimeve të pritshme nga huat dhe normave të interesit të premtuara kontraktualisht. Nga ana tjetër kjo tregon se, përtej një niveli norme interesi, është më mirë për bankat që të zbatojnë racionimin e huas, në vend që të vijnë me klasifikimin e çmimeve, d.m.th. duke i akorduar marzhe më të mëdha rreziku huamarrësve me rrezik më të lartë.

TRI FAKTE TË KOHËVE TË FUNDIT

Personalisht kam dokumentuar tri fakte të rëndësishme, të cilat sugjerojnë një ndryshim në qasjen e bankave ndaj menaxhimit të rrezikut të besueshmërisë, të paktën në lidhje me huat për biznes.


Fakti 1 - Siç tregohet dhe në Grafikon 1, për herë të parë, gjatë vitit 2013, vërehet një rënie e stokut të huas bankare dhe vetëm një rritje të vogël margjinale e saj, gjatë vitit 2014. Nëse marrim parasysh dobësimin e konsiderueshëm, gjatë muajve të fundit, të Lekut ndaj Dollarit Amerikan, rritja e lehtë e huas së re gjatë vitit 2014 është edhe më e vogël. Ky zhvillim tregon se bankat kanë zbatuar shumë më tepër se më parë racionimin e huas.

Grafiku 1 Depozitat, huat dhe pretendimet neto ndaj rezidentëve të huaj.



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe llogaritje të autorit

Grafiku 2 Përfitueshmëria dhe huat me probleme



Burimi: Banka e Shqipërisë dhe bilanci e bankave.

Fakti 2 – Që nga janari i vitit 2009, Banka e Shqipërisë ka realizuar ulje të shumta të normës bazë të interesit. Kjo u pasua nga një rënie graduale e normës mesatare të interesit për huat bankare. Megjithatë, që nga mesi i vitit 2013, ka një rënie të dukshme të përshpejtuar në normat e interesit të huave bankare. Normat mesatare të interesit për huat kanë rënë me rreth 3 pikë përqindje, gjatë periudhës së fundit 18 mujore (korrik 2013 - dhjetor 2014). Kjo është pak a shumë e barabartë me rënie të normave të interesit të huave gjatë gjithë periudhës së fundit 6 vjeçare. Kjo sugjeron që bankat e kanë përdorur më pak diskriminimin përmes normës së interesit, gjatë periudhës së fundit 18 mujore. Për më tepër, kjo duket të jetë një strategji që përdoret nga shumica e bankave, pasi devijimi standard i normave të interesit të huas midis bankave, gjatë vitit 2013, ishte tri herë më i vogël sesa vlera e tij në vitin 2010¹. Kjo tregon se ekziston një "konvergjençë" drejt një niveli të normës së interesit, përtej së cilës racionimi i huas zbatohet fuqishëm nga pjesa dërrmuese e bankave.

Fakti 3 - Zhvillimi fundit, por sigurisht jo më pak i rëndësishëm, është stabilizimi, madje edhe një rënie të lehtë e huave me probleme, sikundër dhe rritja e vazhdueshme e fitimit të sistemit bankar, ku ROE ka arritur një nivel të kënaqshëm prej 10.9 % në fund të vitit 2014 (Grafiku 3). Sigurisht, kjo tregon qartë se strategjia

e re "me këmbë në tokë" po funksionon mirë edhe për sistemin bankar.

STRATEGJIA PO FUNKSIONON, POR GJENDJA E GRUPEVE TË INTERESIT NUK ËSHTË E MIRË

Fitimet në 10.9 % dhe për herë të parë huat me probleme po bien! Ky është një lajm shumë i mirë për bankat, por duket të jetë disi në kontrast me fatin e dy prej grupeve kryesore të interesit për bankat, përkatësisht të depozituesve dhe të bizneseve.

Le të shikojmë së pari depozituesit. Meqenëse diferenca midis normave të interesit për huat dhe depozitat është afër mesatares shumëvjeçare, rënia e përshpejtuar e normave të interesit për huat nënkupton një rënie simetrike në normat e interesit për depozitat bankare. Në të vërtetë, norma mesatare njëvjeçare e interesit për depozitat bankare arriti minimumin historik në dhjetor të vitit 2014. Në këto rrethana, bankat duhet të jenë të vetëdijshme për efektet anësore të rënies së normave të interesit drejt territorit "poshtë normës së inflacionit". Rreziku këtu është që depozitat bankare - burimi kryesor dhe i qëndrueshëm i financimit për bankat - të fillojnë të lëkunden, si pasojë e ndërlikimit të marrëdhënies së tyre me depozituesit. Si shenjë e parë paralajmëruese në këtë drejtim shërben rënia vjetore, për herë të parë, e depozitave bankare në Lek me 3,34 %, në vitin 2014.

Po për bizneset? Së pari, të ardhurat e qeverisë nga tatimi mbi të fitimin në janar 2015 ka qenë në rënie të lirë (-15.7 %), në krahasim me të njëjtin muaj, një vit më parë. Kjo tregon për një situatë të vështirë me fitimet e sektorit të bizneseve, por ka dhe diçka tjetër. Është e vërtetë se Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK), pra inflacioni ka qenë pozitiv, edhe në nivele të ulëta, por Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP), sipas të dhënave të INSTAT-it, ka qenë në territor negativ për dy vjet rresht (- 0,41 % në vitin 2013 dhe - 0,45% në vitin 2014). Kjo nënkupton që sektori i bizneseve është përballur me të ashtuquajturin "deflacion i borxhit", d.m.th. me të ardhura rënëse nga shitjet, që lidhet me pagesat e vazhdueshme të shërbimit të borxhit.

PËRFUNDIMI

Si përfundim, mendoj se ka disa fakte të qarta që nënkuptojnë se bankat po përdorin një strategji të re "me këmbë në tokë", për kontrollin e rrezikut të besueshmërisë. Kjo nënkupton më pak diskriminim përmes normës së interesit dhe më shumë racionim të huas. Strategjia, e cila duhet të përdorur kohë më parë, ka filluar të japë rezultat. Megjithatë, për të qenë e suksesshme në afat të gjatë, mendoj se kjo strategji duhet të zbatohet me kujdes, duke marrë në konsideratë edhe gjendjen e grupeve të rëndësishme të interesit për bankat, si: depozituesit dhe bizneset.

¹ Falenderoj Dokt. Mimoza Agolli, për të dhënat dhe llogaritjet e devijimit standard.



nga **Z. Altin KADAREJA, MSc,**

Konsulent senior

PROMETEIA S.P.A., MILANO, ITALI

Në 31 mars 2015, Banka e Shqipërisë miratoi rregulloren “Për Kapitalin Rregullator të Bankës”, duke përcaktuar strukturën me elementët përbërës dhe metodën e llogaritjes, së bashku me nivelin minimal të kapitalit rregullator të bankës, kapital ky që i kërkohet bankave për të mbuluar rreziqet e besueshmërisë, të tregut dhe atë operacional. Kjo rregullore përfshihet në gamën e rregulloreve të mjaftueshmërisë së kapitalit, me qëllim ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar, e derivuar sigurisht nga kuadri rregullator i Bazelit. Në veçanti, Bazel II kërkon të trajtojë pikërisht problemin e destabilitetit sistematik si pasojë e falimentimit të bankave, duke i bërë kërkesat për kapital shumë më të ndjeshme ndaj rrezikut. Megjithëse i publikuar që në 2001, shumë praktikues të rrezikut bankar (menaxher, rregullator, konsulent dhe profesor) nuk janë ende të bindur për arritjen e rezultateve nga ky kuadër rregullator.

Një nga problemet e shumë lakuar është pro-cikliteti. Në biznesin bankar rreziqet janë të lidhura dhe korreluara me

Përlllogaritja e rrezikut nëpërmjet modeleve të brendshme, një mundësi për t’u konsideruar

Bankat tregtare dhe niveli i lartë i menaxhimit duhet të konsiderojë optimizimin e përdorimit të kapitalit bankar, e nga ana tjetër, banka qendrore duhet të konsiderojë evolucionin natyral të modeleve bankare, drejt ofrimit të mundësive të zbatimit të tyre.

ciklin e biznesit, duke përfshirë me të edhe ekspozimet të peshuara me rrezikun. Në rastin e një rënijeje ekonomike sasia e këtyre ekspozimeve do të rritet, duke ulur raportin e kapitalit rregullator të kërkuar. Kjo do të “detyrojë” bankat të rrisin kapitalin, ose të ulin sasinë e ekspozimeve të peshuara me rrezik. Duke qenë se në periudhën afatshkurtër rritja e kapitalit është e vështirë, bankat ose do të ulin huan për ekonominë, ose do u duhet të zëvendësojnë ekspozimet drejt atyre me rrezik më të ulët. Kështu, nëse një pjesë e bankave do të veprojnë në të njëjtën mënyrë atëherë huaja për ekonominë do të ulet, e si rrjedhojë, ky shtrëngim i kapitalit rregullator do të stimulojë edhe më shumë recesionin. Efekti i kundërt do të ndodhë në rastin e një bumi ekonomik, ku sasia e ekspozimeve të peshuara me rrezik do të ulet, duke rritur raportin e kapitalit, e si rrjedhojë, huadhënien bankare për ekonominë.

Në të dy rastet, kërkesat minimale të kapitalit dhe pro-cikliteti do të amplifikojnë ciklin e biznesit, respektivisht duke thelluar rënien gjatë recesionit dhe përforcuar rritjen gjatë zgjerimit të ekonomisë; me pak fjalë duke prodhuar efekte ekzaktësisht të kundërta me atë që kuadri rregullator i Bazel II kërkonte të arrinte. Gjithsesi, kjo është pikëpamja makroekonomike, ende e pakonfirmuar, si hipotezë e efekteve të Bazel II. Përparesitë efektive të këtyre rregulloreve preken në kuadrin mikroekonomik. Në formulën e përlllogaritjes së kapitalit rre-

gullator përfshihet kapitali i nivelit të parë dhe ai i nivelit të dytë, të raportuar me ekspozimet e peshuara me rrezikun. Pikërisht llogaritja e emëruesit të kësaj formule, që pasqyron profilin e portofolit të bankës në termat e rrezikut të huas, ofron mundësinë për ndryshimin e nivelit të kapitalit rregullator të kërkuar.

Ekspozimet e peshuara me rrezikun janë funksion i parametrave të brendshëm të rrezikut të besueshmërisë (kredisë). Në banka të ndryshme llogaritja e këtyre parametrave është e bazuar në modele të caktuar që marrin parasysh si karakteristikat e huamarrësit, ashtu edhe ato të transaksionit. Megjithatë, modelet që përgjithësisht dominojnë janë ato që konsiderojnë probabilitetin e mospagimit të huamarrësit, duke inkuorporuar përqindjen e sasisë që banka do të humbasë, së bashku me sasinë që banka është e ekspozuar, në rast mospagimi. Të tri elementët së bashku (Probability of Default (PD), Loss Given Default (LGD) and Exposure At Default (EAD)) përbëjnë thelbin e humbjes ekonomike (EL). Për llogaritjen e këtyre parametrave, komiteti i Bazelit ka ofruar dy metoda, tashmë të konsideruara nga shumë aktorë të tregut bankar (rregullatorët qendrorë dhe bankat e nivelit të dytë), si thembra e Akilit në objektivin për uljen e kapitalit rregullator: Metoda Standarde dhe ajo e Brendshme. Në metodën standarde parametrat për llogaritjen e ekspozimeve të peshuara me rrezikun llogariten në bazë të

OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE
NË TREGUN BANKAR!



CBA JU OFRON:

Depozita, llogari rrjedhëse dhe me afat, transferta parash, garanci bankare, shkëmbime dhe të gjitha shërbimet tradicionale bankare.

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi",
Ndërtesa Administrative "AL-KHARAFI"
(pranë Fuktetit Juridik)
Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 42 272168/66; Fax +355 42 272162
E-mail: creditbkalb@icc-al.org
creditcba@icc-al.org

Sheraton Tirana Hotel
Shopping Plaza
Tel: +355 42 2255372/388/368/346
Fax: +355 42 255340

Hotel "Butrinti" Sarandë
Tel: +355 85 225405

analizave të kryera nga institucione të jashtme të vlerësimit të besueshmërisë dhe peshimi nga rregullatorët qendrorë. Të gjithë parametrat merren nga burime të jashtme për bankën.

Sipas metodës së modeleve të brendshme, parametrat për llogaritjen e ekspozimeve të peshuara me rrezikun janë të llogaritura nga modele/burime të brendshme të bankës. Metoda e modeleve të brendshme ndahet në dy nën-metoda: themeltare dhe të avancuar. Diferenca midis të dy metodave qëndron në mënyrën e përlllogaritjes së parametrave të përmendur më sipër (PD, LGD, EAD). Në metodën themeltare të modeleve të brendshme, bankat mund të llogarisin me modelet e tyre vetëm një nga parametrat e rrezikut të huas, atë të probabilitetit të mospagimit të huamarrësit (PD). Parametrat e tjerë janë të standardizuar. Sipas metodës së avancuar të modeleve të brendshme, bankat mund llogarisin të tre parametrat (PD, LGD, EAD) nëpërmjet modeleve të brendshëm dhe t'i përdorin ato për të llogaritur ekspozimet e peshuara me rrezik.

Nëse krahasojmë të tre metodologjitë, duke marrë parasysh nga njëra anë mangësinë e metodologjive - kompleksitetin e llogaritjes - dhe nga ana tjetër përparësinë - uljen e kapitalit të kërkuar - rezulton grafiku i mëposhtëm.

Siç mund të kuptohet, metodat e llogaritjes së parametrave të rrezikut të besueshmërisë nëpërmjet modeleve të brendshëm bazohen shumë në vlerësimet që vet banka arrin të kryejë, për identifikimin e profilit të rrezikut për portofolin e klientelës së saj. Sigurisht, për të arritur në këto nivele pavarësie kërkohet eksperiencia e duhur, si në terma teknike ashtu dhe ato kohore. Ajo që është interesante për t'u analizuar, është përparësia dhe vlera e shtuar

që këto metoda kanë për biznesin bankar. Konkretisht, mund të përmenden dy përparësi kryesore, si në vijim:


Së pari, ndjeshmëri më të lartë ndaj rrezikut. Nëpërmjet këtyre modeleve bankat arrijnë të identifikojnë, në mënyrën më të saktë, profilin e rrezikshmërisë së klientit. Kërkesat e kapitalit kur bazohen në këtë metodologji janë më të ndjeshme përkundrejt rrezikut të besueshmërisë dhe ndaj humbjeve ekonomike në portofolin e bankës.

Së dyti, përmirësimi i sistemeve të brendshme të rrezikut. Bankat kur marrin miratimin për të përdorur metodologjitë e brendshme të përlllogaritjes së parametrave të rrezikut, duhet të përfshijnë përdorimin e këtyre parametrave në pjesën më të madhe të proceseve dhe procedurave bankare, që nga menaxhimi i huadhënies, menaxhimi i kapitalit, vendim-marrja dhe pozicionimi strategjik, etj. Kjo përfshirje e parametrave të rrezikut në proceset e vendim-marrjes bankare jo vetëm do të përmirësojë sistemet e brendshme të rrezikut, por do të mundësojë përhapjen e një kulture të rrezikut në të gjitha nivelet e menaxhimit të bankës.

Në këtë panoramë, kuptohet qartë që të gjithë bankat do të dëshironin përdorimin e metodës së avancuar të modeleve të brendshme, me qëllim uljen e kapitalit të kërkuar. Gjithsesi, kjo nuk vjen pa kosto. Në mënyrë që bankat të arrijnë në këto nivele të pavarësisë të llogaritjes së parametrave, ato duhet të kërkojnë dhe marrin miratimin e bankës qendrore, e për ta bërë këtë, kërkohet angazhim maksimal dhe investime të konsiderueshme në jetësimin e strukturës së metodës/modeleve të brendshme të llogaritjes së parametrave të rrezikut të besueshmërisë. Në krahuin tjetër, përdorimi i metodës standarde është

pozitive, pasi kufizon efektin e pro-ciklilit, duke qenë se llogaritja e jashtme e parametrave është më pak e ndjeshme, sesa llogaritja e brendshme, duke prodhuar peshim më të qëndrueshëm të rreziqeve. Gjithsesi, metoda standarde ofron nxitës që bizneset të kryejnë atë që quhet "rate shopping", me qëllim uljen e kostove të borxhit, duke detyruar bankat të ofrojnë llogaritje të parametrave të rrezikut artificial (duke qenë se kanë parametra të jashtëm të llogaritjes), pa konsideruar saktësisht profilin e rrezikshmërisë së klientit.

Në përfundim, situata ekonomike shqiptare dhe numri i ulët i krizave ekonomike e ka ndihmuar sektorin bankar që mos ketë luhatje të forta në kapitalin rregullator dhe nevojë për përshtatjen e tij. Megjithatë, bankat tregtare dhe niveli i lartë i menaxhimit duhet të konsiderojë optimizimin e përdorimit të kapitalit bankar, e nga ana tjetër, banka qendrore duhet të konsiderojë evolucionin natyral të modeleve bankare, drejt ofrimit të mundësive të zbatimit të tyre. Modelet e brendshme të rrezikut janë një "pasuri" e pashfrytëzuar ende nga tregu bankar shqiptar. Sigurisht, zbatimi i i kuadrit rregullator dhe jetësimin efektiv të tyre në banka kërkon kohën e duhur, si në varësi të eksperiencës së tregut, ashtu dhe të periudhës kohore të nevojshme për vënien në jetë të kësaj metodologjie. Gjithsesi, përparësitë e përdorimit të këtyre modeleve janë të konsiderueshme, pasi eksperiencat e fundit të vërejtura tregojnë se kalimi nga metodologjia standarde drejt modeleve të brendshme themeltare i ul bankës kapitalin rregullator me 10-20%, ndërsa kalimi nga metodologjia standarde drejt modeleve të brendshme të avancuar me respektivisht 20-30%.





nga **Z. Anton LEZHJA**¹

Drejtor, Vlerësim dhe Modelim,
Shërbime të Këshillimit Financiar
DELOITTE ALBANIA DHE KOSOVA

Gjatë vitit 2014 e në vijim, duke punuar për vlerësimin e pasurive të paluajtshme, në biseda e diskutime me ekspertë vlerësues e punonjës të bankave janë shtruar disa pyetje që lidhen me vlerat e pasurive të paluajtshme në kushtet aktuale të tregut, si p.sh.: “Si përcaktohet vlera e tregut kur nuk ka transaksione në treg?”, ose “Pse vlerësuesit nuk përdorin kapitalizimin e qirasë si metodën bazë për vlerësimin e pronave apartament, dyqan, ose tokë?” Ky artikull është një përpjekje për të dhënë disa konsiderata, edhe pse mund të mos jenë zgjidhja e çdo pyetjeje.

Çdo çmim pasqyron pikëprerjen midis ofertës dhe kërkesës, por a po funksionon kjo në tregun aktual të pasurive të paluajtshme në Shqipëri? Ajo çka po shohim thuhet në të gjithë vendin është një tkurrje e ndjeshme e transaksioneve, madje edhe për zonat ekskluzive të qyteteve tona. Mungesa e transaksioneve, së pari, tregon se pozicionet e shitësit dhe blerësit janë shumë larg

Konsiderata mbi vlerësimin e pasurive të paluajtshme në kushtet e sotme

Që në fillimet e funksionimit të tregut të pasurive të paluajtshme, pas viteve '90, metoda e krahasimit të drejtpërdrejt dhe ajo e kapitalizimit të qirasë kanë dhënë rezultate shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Ndryshimi i madh midis vlerave të metodës së krahasimit dhe kapitalizimit të qirasë do të shpjegohej nga ekzistenca e të ardhurave të tjera, përveç pagave në familjet shqiptare.

nga njëri-tjetri, e për shumë arsye, asnjë palë nuk pranon t'i afrohet tjetrës. Koncepti i vlerës së tregut bazohet kryekëput në ekzistencën e një shitësi të vullnetshëm dhe një blerësi të vullnetshëm, të cilët arrijnë një marrëveshje për të këmbyer një pronë, në një datë të caktuar. Fakti që një shitës nuk do të shesë tani, sepse nuk mund të marrë atë që pret nga prona e tij, apo që një blerës pret që çmimet të ulen dhe nuk hyn tani në transaksion, nuk bëjnë pjesë në konceptin e vlerës së tregut. Në këto kushte, si do të përcaktonte një vlerësues vlerën e tregut, kur thuajse nuk ka treg? Një nga format që mund të konsiderojë vlerësuesi është analizimi i të dhënave që vijnë, si nga aspekti mikro-ekonomik, ashtu dhe nga ai makro-ekonomik, për të arritur në pikëprerjen më probabël midis ofertës dhe kërkesës.

1. Në aspektin mikro-ekonomik, vlera e tregut përcaktohet nga metoda e njohura të vlerësimit, ku më e përdorura është metoda e krahasimit të drejtpërdrejt. Siç u shpjegua më lart, metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë, mund të mos jetë e mjaftueshme për të arritur në vlerën e tregut. Një metodë tjetër e përdorur për vlerësimin e pronave është edhe kapitalizimi i qirasë; metodë që thuajse nuk është përdorur në vlerësimin e baneve. Që në fillimet e funksionimit të tregut të pasurive të paluajtshme, pas viteve '90,

metoda e krahasimit të drejtpërdrejt dhe ajo e kapitalizimit të qirasë kanë dhënë rezultate shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Këtë do ta ilustrojmë me një shembull.

Një apartament me një sipërfaqe mesatare rreth 70-80 m² në qendër të Tiranës mund të jepet me qira rreth 250-300 euro në muaj, i mobiluar, por pretendohet të shitet në diapazonin e çmimit 1,000-1,200 euro/m². Pa marrë parasysh axhustimet e nevojshme të qirasë, për shkak të kontributit të mobilimit në të, të diferencës midis sipërfaqes së banimit me sipërfaqen e përgjithshme (përfshirë edhe sipërfaqet e përbashkëta), apo qëndrimin bosh nga skadimi i njëres kontratë qiraje deri te firmosja e një kontrate të re, qiraja për m² do të ishte afërsisht 3.6-3.8 euro/m² në muaj, ose 43-45 euro/m² në vit. Raporti midis qirasë vjetore dhe çmimit të shitjes jep atë që njihet me emrin yield (norma e rikthimit të kapitalit). Në shembullin tonë ky yield rezulton 3.8% (45/1,200), deri në 4.3% (43/1,000). Duke qenë se yield-i është dhe një tregues i rrezikut të investimit, ky rezultat e vendos Tiranën në të njëjtin nivel rreziku investimi me qytete si: Londra, Parisi, Berlina, etj. Kjo nuk mund të jetë e vërtetë, pasi po të bazohemi në analizën e rrezikut të investimeve në pasuritë e paluajtshme në Tiranë, rezultoni që në kushtet e sotme të tregut, por edhe në parashikimet afatmesme, yield-i duhet të


¹ Anton Lezhja është një vlerësues i shkallës senior dhe anëtar i American Society of Appraisers (ASA) dhe i Royal Institution of Chartered Surveyors (RICS), i Shoqërisë së Vlerësuesve të Pasurive të Paluajtshme (SVP), si dhe është licencuar si vlerësues i pasurive në Shqipëri dhe Kosovë.

jetë në nivelet 10-12%. Duke kapitalizuar qiratë e mësipërme me këtë yield, do të kishim vlera të pronave në nivelin e 375-430 euro/m², shifër kjo shumë afër kostos mesatare të ndërtimit në Tiranë dhe 3-4 herë më pak se çmimet e shitjes së pronave. Ky fenomen vërehet edhe në vende të tjera të rajonit dhe arsyet mund të jenë të ndryshme, duke filluar nga dëshira e qytetarëve për të zotëruar pronat më shumë sesa për të jetuar në pronë të tjetër, pasiguria lidhur me vlefshmërinë e kontratave afatgjata të qirasë (d.m.th. kur qiradhënësi ndërpret papritur kontratën apo se dëshiron ta shesë shtëpinë), ose ekzistenca e të ardhurave të tjera, përtej pagave, etj.

2. Për të konkluduar se çfarë peshe duhet t'i japim secilës metodë të analizuar më lart, i referohemi aspektit makro-ekonomik, sipas të cilit tregu i pasurive të paluajtshme analizohet mbi bazën e disa parametrave, ku më kryesorët janë:

- i. çmimi i banesës/të ardhurat vjetore, është treguesi bazë mbi përbalueshmërinë e blerjes së një banese në një zonë të caktuar. Ai është përgjithësisht raporti i çmimit mesatar të shtëpive ndaj të ardhurave mesatare vjetore të disponueshme të familjes, i shprehur në përqindje, ose si numri i viteve të të ardhurave vjetore. Ky raport afatgjatë tregon se vlera e një shtëpie që një familje përballon është 3-4 vjet të ardhura;
- ii. raporti i depozitës ndaj të ardhurave, është minimumi i kërkuar i pagesës fillestare (downpayment) për një hua strehimi, i shprehur në muaj apo vite të ardhurash;
- iii. indeksi i përbalueshmërisë, mat raportin e kostos mujore të një huaje me të ardhurën neto të familjes. Ky tregues, i përdorur më shumë në Mbretërinë e Bashkuar, ofron një matës më realist lidhur me aftësinë e familjeve për të përbaluar blerjen e një shtëpie, sesa treguesi çmim/të ardhurat. Gjithsesi, për shkak të vështirësisë në llogaritje, përdoret më shumë treguesi i parë.

Dy grafikët e mësipërm tregojnë ecurinë e koeficientit çmim banese/të ardhura vjetore në periudhën 1976-2011 dhe shpërndarjen e tij në rajonin e Europës, në vitin 2015. Mesatarja afatgjatë e këtij koeficienti është 3.5 vjet, kurse në vitet e fundit është rritur në 5-5.5 vjet. Në grafikun djathtas njollat jeshile tregojnë një koeficient të ulët, kurse



të quajet një koeficient të lartë.

Të ardhurat mesatare të një familje në Shqipëri llogariten të jenë rreth 60-65 mijë lekë në muaj (430-465 euro/muaj), ose 5,143-5,571 euro/vit. Këto të ardhura përshtajnë thuhetse ekskluzivisht pagat, pasi nuk ka të dhëna statistikore lidhur me të ardhura të tjera që fiton një familje. Duke aplikuar një koeficient çmim banese/e ardhura vjetore afatgjatë prej 5-6 vjet rezultojnë se çmimi i një shtëpie që familja mesatare do të mund të përballonte do të ishte në diapazonin 25,700-33,400 euro. Nëse apartamenti që një familje mesatare do të kishte nevojë do të varionte në 70-80 m², çmimi për m² që familja mesatare do të përballonte është 367-418 euro/m². Ky çmim është shumë afër rezultatit të mësipërm nga metoda e kapitalizimit të qirasë. Ndryshimi i madh

midis vlerave të metodës së krahasimit dhe kapitalizimit të qirasë do të shpjegohej nga ekzistenca e të ardhurave të tjera, përveç pagave në familjet shqiptare.

Konkluzion: Për sa kohë ekzistojnë transaksione në treg, vlera e tregut e pasurive të paluajtshme do të përcaktohej prej tyre, pavarësisht nga prejardhja dhe përbërja e burimeve financiare të familjeve. Nëse burimet financiare të familjeve do të zvogëlohen, atëherë vlera e tregut të pasurive do të afrohej drejt vlerave të përbalueshme nga pagat e familjeve dhe numri i transaksioneve do të binte. Në këto kushte, metoda e kapitalizimit të qirasë do të merrte më shumë peshë në arritjen e vlerës së tregut. Sidoqoftë, eksperti vlerësues është ai që ka fjalën e fundit dhe përgjegjësinë në çmimin e vlerës së tregut të pronës.



² i) E Ardhura mesatare e familjes përkufizohet si e ardhura bruto nga të gjitha burimet, përfshirë pagat, të ardhurat nga bizneset, ose veprimtari informale, të ardhura nga investimet, por dhe të ardhura në natyrë, si p.sh.: konsumi i produkteve bujqësore.
ii) Çmimi mesatar i banesave: Banesë me çmim mesatar quhet ajo banesë që ka 50% të shtëpive poshtë çmimit të saj dhe 50% mbi çmimin e saj. Vlera e një shtëpie përkufizohet si çmimi me të cilin do të shitej një shtëpi, nëse do të nxirrej në treg për një periudhë kohe të arsyeshme nga një shitës që nuk është në trysni për të shitur.



nga **Z. Stavri PASHKO**

Drejtor Ekzekutiv
INSTITUTI SHQIPTAR I AUDITUESVE
TË BRENDSHËM (AIIA)

S ektori bankar shqiptar ka qënë shpesh në qendër të vëmendjes, përsa i përket një sërë rastesh të mashtrimeve financiare, të ndodhura sidomos vitet e fundit. Mashtrimi është një kërcënim i vazhdueshëm (dhe jo vetëm për bankat), që rritet nga faktorë të ndryshëm, si p.sh. struktura organizative dhe shtrirja gjeografike e shoqërisë. Sipas një raporti të Shoqatës së Inspektorëve të Çertifikuar të Mashtrimit, në mbarë botën organizatat humbin çdo vit rreth 5% të të ardhurave si pasojë e mashtrimit. Nisur nga fakti që, në vendin tonë nuk zotërohen statistika të sakta mbi këtë çështje, ajo çka mund të thuhet me siguri është se jo pak organizata, e sidomos bankat, kanë rënë pre e mashtrimeve të ndodhura, me humbje operacionale që shpesh llogariten në miliona euro. Në të tilla raste, bankat apo organizata të tjera mund të pësojnë gjithashtu dhe dëm të reputacionit, disa herë më i madh edhe se vetë humbjet operacionale. Falë natyrës së biznesit, kur një rast mashtrimi ndodh në një

Auditimi i brendshëm

Roli i tij në shmangien e mashtrimeve bankare

◀◀ Audituesit e brendshëm kanë rolin e tyre në betejën kundër mashtrimit dhe vjedhjes brenda bankës. Ata kryejnë vlerësime dhe japin rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrolleve të brendshme në mënyrë që, midis të tjerash, shoqëria të jetë në gjendje të parandalojë dhe të zbulojë në kohë ngjarjen e mashtrimit.

bankë, jo rrallë ndodh që klientët të nxitonjë të tërheqin apo të verifikojnë shumat e depozituara në të.

Kur mashtrimi ndodh, zakonisht audituesit e brendshëm thirren në apel. Komente të ngjashme si: “Ku ishte auditimi”, apo “Si nuk e kapën audituesit e brendshëm...” janë tashmë pjesë e rutinës post-mashtrim. Edhe vetë audituesit e brendshëm shpesh u rikthehen punës së tyre, në kërkim të sigurisë që kanë bërë atë çka ka qënë e mundur. Drejtimi ekzekutiv dhe bordi, midis të tjerash, kërkon informacion nëse funksioni i auditimit të brendshëm ka qënë i pranishëm së fundmi në perimetrin ku ka ndodhur mashtrimi. Regjime të tilla nuk kanë të bëjnë vetëm me mjedisin shqiptar. Ato mund të hasen kudo nëpër botë dhe sidomos në mjedise ku figura e audituesit të brendshëm vazhdon të bashkërenditet krahas një figure policore dhe një qenie me një mijë sy e veshë, që sheh dhe dëgjon gjithçka. Ndërsa nuk ka dyshim mbi rolin që luan auditimi i brendshëm në parandalimin dhe kërkimin për mashtrim të mundshëm, vëmendja duhet ndalur mbi atë se deri ku shkon përgjegjësia e auditimit të brendshëm.

Mashtrimet dhe vjedhjet ndodhin shpesh si pasojë e dobësive të gjetura në sistemin e kontrolleve të brendshme. Modele ndërkombëtare të qeverisjes theksojnë se, menaxhimi është përgjegjës për projek-

timin, vendosjen dhe mbarëvajtjen e sistemit të kontrolleve të brendshëm, duke përfshirë këtu dhe aftësinë për të parandaluar dhe zbuluar vjedhje të mundshme dhe mashtrime. Sipas rregullores nr. 63 të Bankës së Shqipërisë: “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”, është drejtorja ajo që duhet të ndërmarrë masat e nevojshme, për të monitoruar dhe admin-

◀◀ Qëllimi kryesor i veprimtarisë së auditimit të brendshëm nuk është hetimi dhe zbulimi i mashtrimit por që të japë siguri të arsyeshme, që objektivat e procesit të audituar janë arritur dhe që mangësitë e kontrolleve që mund të çojnë në materialitet – pa apo me qëllim – janë të zbuluara.


istruar të gjitha rreziqet ndaj të cilave është e ekspozuar banka. Midis këtyre rreziqeve renditet dhe ai i mashtrimit, si një nga rreziqet operationale më të përfolura në sektorin bankar, në sajë të pranisë së aktiveve likuide.

Sigurisht, audituesit e brendshëm kanë rolin e tyre në betejën kundër mashtrimit dhe vjedhjes brenda bankës. Audituesit kryejnë vlerësime dhe japin rekomandime për përmirësimin e sistemit të kontrolleve të brendshme në mënyrë që, midis të tjerash, shoqëria të jetë në gjendje të parandalojë dhe të zbulojë në kohë ngjarjen e mashtrimit. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm u kërkojnë audituesve të konsiderojnë rrezikun e mashtrimit kur planifikojnë angazhimet e tyre, në mënyrë që të përfshijnë në këto angazhime testime, që mund të ndihmojnë në zbulimin e mundshëm të mashtrimeve. Për këtë, audituesit duhet të kenë njohuri të mjaftueshme mbi dinamikën, arsyet mbi ngjarjen së mashtrimit dhe si të njohin sinjalet që tregojnë për praninë e mundshme të mashtrimit.

Sipas Norman Marks, ekspert në fushën e qeverisjes, rrezikut dhe auditimit të brendshëm, përgjegjësia e audituesit të brendshëm vjen pasi është shqyrtuar qartë përgjegjësia e drejtuesve të procesit ku ka ndodhur mashtrimi. P.sh: nëse mashtrimi ndodh në njësinë e burimeve njerëzore, është drejtuesi i kësaj njësie organizative, fillimisht përgjegjës për mbarëvajtjen e kontrolleve të brendshme, që ndihmojnë në parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit. Një shembull i këtyre kontrolleve është autorizimi për regjistrimin e punonjësve të rinj në sistemin e pagave. Nëse drejtuesi i burimeve njerëzore nuk vendos apo nuk kryen një kontroll të tillë, atëherë ai është bashkëpërgjegjës për skemën e mashtrimit që ndodh në këtë proces (trillimi i një punonjësi për të kaluar rrogën e tij në një llogari bankare të vetë mashtruesit). Edhe vetë modeli i “Tre Linjave të Mbrojtjes” mbështet rolin “dytësor” që duhet të mbajë auditimi i brendshëm, ndërsa menaxhimi ka përgjegjësi kryesore për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit.

Auditimi i brendshëm mund të jetë shumë më i dobishëm dhe më i efektshëm për organizatën, nëse i jepet roli që i takon. Shpesh bordi dhe menaxhimi i kërkojnë auditimit të brendshëm të shpenzojë mjaft kohë në hetimin e mashtrimeve, ndërkohë që kjo përgjegjësi duhet të shpërndahet midis linjave të ndryshme të mbrojtjes. Për më tepër, vlen të theksohet se, ndërsa au-

TRE LINJAT E MODELIT TË MBROJTJES



Mashtrimet dhe vjedhjet ndodhin shpesh si pasojë e dobësive të gjetura në sistemin e kontrolleve të brendshme. Modele ndërkombëtare të qeverisjes theksojnë se, menaxhimi është përgjegjës për projektimin, vendosjen dhe mbarëvajtjen e sistemit të kontrolleve të brendshëm, duke përfshirë këtu dhe aftësinë për të parandaluar dhe zbuluar vjedhje të mundshme dhe mashtrime.



dituesit e brendshëm duhet të vlerësojnë rrezikun e mashtrimit si një procedurë standarde e veprimtarisë së tyre, jo të gjithëve u kërkohet të kenë shkallën e ekspertizës dhe aftësitë profesionale që mund të ketë një profesionist që vepron vetëm në fushën e hetimit të mashtrimeve. Vetë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm, një udhëzim i rëndësishëm ky për profesionin e audituesit të brendshëm, nuk u hartuan për të ndaluar apo identifikuar mashtrimin. Disa banka dhe institucione të tjera në Shqipëri e kanë kuptuar këtë, duke ngritur brenda strukturave të tyre njësi të specializuara që merren vetëm me analiza për hetimin dhe zbulimin e mashtrimeve.

Në linjën e tretë të mbrojtjes, auditimi i brendshëm mund të kryejë më së miri funksionin e tij, duke përdorur instrumentet e duhura për të zbuluar rastet e mashtrimit që mund t’u kenë shpëtuar kontrolleve të vendosura fillimisht në proceset, e që bashkë me biznesin gjenerojnë dhe rrezikun e mashtrimit. Më pas, në rastet e zbulimit të mashtrimit apo vjedhjes, au-

dituesit e brendshëm mund të punojnë ngushtë me menaxhimin, duke dhënë rekomandimet e duhura për të forcuar linjat e tyre të mbrojtjes. Qëllimi kryesor i veprimtarisë së auditimit të brendshëm nuk është hetimi dhe zbulimi i mashtrimit por që të japë siguri të arsyeshme, që objektivat e procesit të audituar janë arritur dhe që mangësitë e kontrolleve që mund të çojnë në materialitet – pa apo me qëllim - janë të zbuluara.

Lufta kundër mashtrimit dhe çdo parregullsie tjetër është një luftë e çdo pjesëtari të organizatës. Sipas kornizës së COSO-s, gjithësekush në organizatë ka përgjegjësi përkatëse për kontrollet e brendshme. Staf i drejtues duhet të promovojë dhe të krijojë në organizatën përkatëse një klimë etike dhe vetpërgjegjësie, si e vetmja armë efiçente dhe e efektshme ndaj mashtrimit dhe parregullsive të tjera. Audituesit e brendshëm duhet të përdorin njohuritë dhe ekspertizën e tyre për të mbështetur menaxhimin dhe organizatën për krijimin e kontrolleve dhe instrumenteve mbrojtës ndaj mashtrimit dhe rreziqeve të tjera.

KREDI PËR PUSHIME

JU SHIHNI ËNDRRA ME PUSHIME, NE JU MUNDËSOJMË PUSHIMET E ËNDRRAVE.

☎ 04 22 34 096 @ www.bankacredins.com ✉ shitja@bankacredins.com

Me pushime, merrni çdo gjë me vete përveç kredisë.


Ejani në **CREDINS Bank** për të përfitur nga oferta më e re e kredisë për pushime:

SHEMBULL

Shuma	Afati	Kësti
100.000 all	18 muaj	5.960 all / muaj

Shijoni pushimet siç i keni ëndërruar.
CREDINS Bank, ju uron pushime të mbara!

 **CREDINS** bank





nga Z. Ayhan AKAY

Konsulent për Menaxhimin e Rrezikut
SBPST SH.P.K.

Rreziku i besueshmërisë (kredisë) përcaktohet thjesht si mundësia që një huamarrës në bankë ose palë e tretë të dështojnë në përbushjen e detyrimeve të tij/saj, në përputhje me kushtet e rëna dakord. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të besueshmërisë në bankë është maksimizimi i normës së kthimit të rregulluar me rrezikun, duke e mbajtur ekspozimin ndaj rrezikut të besueshmërisë brenda parametrave të pranueshëm.

Për bankat është i nevojshëm menaxhimi i rrezikut të besueshmërisë që natyrshëm shoqëron portofolin e tyre të huas, sikundër dhe rrezikun e huave apo transaksioneve individuale. Gjithashtu, banka duhet të marrë në konsideratë marrëdhëniet ndërmjet rrezikut të besueshmërisë dhe rreziqeve të tjera. Menaxhimi efektiv i rrezikut të besueshmërisë përbën një element kritik për një qasje gjithëpërfshirëse të menaxhimit të rrezikut, si dhe është thelbësor për suksesin afatgjatë të çdo organizate bankare.

Përdorimi i pikëvlerësimit gjatë menaxhimit të rrezikut

1 Pikëvlerësimi i besueshmërisë përbën ndoshta një nga aplikimet më "klasike" për modelet parashikuese, që parashikon nëse huaja që i akordohet një kërkuesi të saj, do të rezultojë ose jo me fitim apo humbje për institucionin e kreditit.

STRATEGJIA E RREZIKUT TË BESUESHMËRISË DUHET TË SIGUROJË, PËR ÇDO BANKË, VAZHDIMËSI NË QASJEN E ZBATUAR

Logjikshëm, strategjia do të duhet të marrë në konsideratë aspektet ciklike të çdo ekonomie si dhe "zhvendosjet" përkatëse që rezultojnë në përbërjen dhe cilësinë e portofolit të përgjithshëm të huave. Pavarësisht faktit se strategjia duhet të vlerësohet dhe ndryshohet periodikisht, ajo duhet t'i bëjë ballë dhe të jetë e zbatueshme në afatgjatë dhe përmes cikleve të ndryshme ekonomike.

Strategjitë dhe politikat e rrezikut të besueshmërisë duhet të komunikohen në mënyrë efektive në të gjithë organizatën bankare. I gjithë personeli i duhur duhet të kuptojë qartë qasjen e bankës në drejtim të akordimit dhe administrimit të huas, ndërkohë që ai duhet të mbajë përgjegjësi për sigurimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e mirëpërcaktuara. Bankat duhet të kenë në funksion një sistem specifik për administrimin e vazhdueshëm të portofoleve të tyre të huas me profile të ndryshme rreziku.

Pikëvlerësimi i besueshmërisë përbën ndoshta një nga aplikimet më "klasike" për modelet parashikuese, që parashikon nëse huaja që i akordohet një kërkuesi të saj do të rezultojë ose jo me fitim apo humbje për institucionin e kreditit. Ekziston një larmi dhe kompleksitet i madh lidhur me mënyrën se si akordohen huat për individë, biznese

dhe organizata të tjera, sipas qëllimit të përdorimit të tyre (makineri e pajisje, pasuri të patundshme, artikuj konsumi, etj.), duke përdorur lloje të ndryshme huash (karta krediti, hua, hua me pagesa të shtyra, etj.). Megjithatë, në të gjitha rastet, huadhënësi i jep hua fonde likuide një individ apo institucioni dhe pret të ripaguhet në kohë dhe me interesa, që përputhen me rrezikun e mospagimit.

Pikëvlerësimi i besueshmërisë përfaqëson një komplet modelesh për marrje vendimesh, së bashku me teknikat përkatëse, që i ndihmojnë huadhënësit në dhënien e huas për klientët. Këto teknika përcaktojnë se kujt klienti duhet t'i jepet huaja, sa hua duhet t'i jepet dhe cilat strategji operacionale do të rrisin përfitueshmërinë e huamarrësve, në favor të huadhënësve. Për më tepër, ato ndihmojnë në vlerësimin e rrezikut gjatë huadhënies. Pikëvlerësimi i besueshmërisë përbën një vlerësim të besueshëm të integritetit të një personi, pasi bazohet në të dhënat aktuale.

Huadhënësi zakonisht merr dy lloj vendimesh: së pari, nëse do i japë hua një kërkuesi të ri, dhe së dyti, si të vijojë marrëdhënien me klientët ekzistues, përfshirë këtu faktin nëse u duhet rritur atyre kufiri i huamarrjes. Pavarësisht nga teknika e përdorur, në të dy rastet është i rëndësishëm përdorimi i kampioni të madh klientësh ekzistues me të dhënat e tyre të kërkesave për hua, modelet e sjelljes, si dhe historikun

të huas së tyre në vijim. Shumica e teknikave e përdorin këtë kampion për të identifikuar lidhjen midis karakteristikave të klientëve (e ardhura vjetore, mosha, numri i viteve në punësim me punëdhënësin e tyre aktual, etj.) dhe historikun e tyre në vijim.

Fushat tipike të zbatimit të saj në tregun e huave konsumatore përfshijnë: kartat e kreditit, huat për automjete, huat për strehim, huat e kolateralizuara, blerjet me kërkesë-porosi, si dhe një gamë të gjerë produktesh të huas personale.

Zbatimi i modeleve të pikëvlerësimit në mjedisin e sotëm të biznesit mbulon një gamë të gjerë objektivash. Detyra parësore e vlerësimit të rrezikut të mospagimit është zgjeruar edhe me modelet e pikëvlerësimit të besueshmërisë, duke përfshirë edhe aspektet e tjera të menaxhimit të rrezikut të besueshmërisë: në fazën e kërkesës paraprake (identifikimi i kërkuarve të mundshëm), në fazën e paraqitjes së kërkesës (identifikimi i kërkuarve të pranueshëm), si dhe në fazën e ecurisë së huas (identifikimi i sjelljes së mundshme të klientëve aktualë).

Me kohën janë zhvilluar modele pikëvlerësimit me objektiva të ndryshme. Ata mund të përmbledhen në katër kategori, si më poshtë.

PIKËVLERËSIMI PËR QËLLIME MARKETINGU

Identifikon klientët më të besueshëm që kanë më shumë gjasa që t'i përgjigjen veprimtarisë promovuese, me qëllim që të zvogëlohet



Objektivi i përgjithshëm i modeleve pikëvlerësuese të besueshmërisë nuk është vetëm përcaktimi nëse kërkuarri i huas është apo jo i besueshëm, por edhe për të tërhequr kërkuarrit cilësorë të huave, të cilët më pas mund të mbahen dhe të kontrollohen si klientë, ndërkohë që banka zotëron një portofol fitimprurës në përgjithësi.



kosto e "kapjes" së klientëve dhe të minimizohet pakënaqësia e tyre. Parashikon mundësinë e humbjes së klientëve të çmuar dhe u mundëson organizatave të formulojnë strategji efektive për mbajtjen e klientëve.

Pikëvlerësimi për përgjigjen: Janë modele që vlerësojnë se si do të mund të përgjigjet klienti ndaj një mesazhi të drejtpërdrejt prezantues për një produkt të ri.

Pikëvlerësimi për ruajtjen/humbjen: Janë modele pikëvlerësimi që parashikojnë se sa mundësi ka klienti që të vijojë me përdorimin e produktit, ose të ndryshojë huadhënësin, pasi përfundon periudha paraprake e ofertës.

PIKËVLERËSIMI PËR QËLLIME ZBATIMI

Shumë probleme me huat zbulojë dobësitë themelore gjatë proceseve të dhënies dhe monitorimit të huave. Ndërkohë që mangësitë në krijimin dhe menaxhimin ekspozimeve për huat e lidhura me tregun përfaqësojnë burime të rëndësishme të humbjeve për bankat, shumë nga problemet me huat do të ishin shmangur, ose minimizuar, nga zbatimi i një procesi të fortë vlerësimi të brendshëm për besueshmërisë.

Modeli përcakton nëse duhet dhënë huaja dhe sa hua duhet dhënë. Ai parashikon sjelljen e ardhshme të kërkuarrit të ri të huas, duke parashikuar probabilitetet e mospagimit të huas, apo sjelljet e pagesave problematike, në kur është dhënë huaja.

Pikëvlerësimi për kërkuarrit: Janë modele që vlerësojnë mundësitë që një kërkuarri i ri huaje do dështojë në pagesa.

PIKËVLERËSIMI PËR ASPEKTIN E ECURISË

Parashikon sjelljen e debitorëve ekzistues lidhur me pagesat e ardhshme, me qëllim identifikimin/ izolimin e klientëve të këqij, fokusimin e një vëmendjeje dhe ndihmese më të madhe ndaj tyre, duke zvogëluar gjasat që këta debitorë të shndërrohen më vonë në problem për bankën.

Pikëvlerësimi për sjelljen: Janë modele që vlerësojnë nivelet e rrezikut të debitorëve ekzistues.

PIKËVLERËSIMI PËR MENAXHIMIN E BORXHIT TË KEQ

Nëpërmjet tij zgjidhen politikat optimale për mbledhjen e huave me probleme, me qëllim minimizimin e kostos së administrimit të procesit të mbledhjes së huave me probleme, apo maksimizimin e sasisë së huave, që mund të rikuperohen nga llogaritë e klientëve me vonesa në pagesa. Modelet pikëvlerësuese për vendimet e mbledhjes së huave me probleme: Janë modele që për-



caktojnë se kur duhet ndërmarrë veprimet ndaj klientëve me vonesa në pagesa dhe se cilat nga teknikat alternative të mbledhjes së këtyre huave janë më të përshtatshme e më të suksesshme për t'u përdorur.

Pra, objektivi i përgjithshëm i modeleve pikëvlerësuese të besueshmërisë nuk është vetëm përcaktimi nëse kërkuarri i huas është apo jo i besueshëm, por edhe për të tërhequr kërkuarrit cilësorë të huave, të cilët më pas mund të mbahen dhe të kontrollohen si klientë, ndërkohë që banka zotëron një portofol fitimprurës në përgjithësi.

Mungesa e testimit dhe vlefshmërisë së teknikave të reja të pikëvlerësimit të besueshmërisë është një tjetër problem i rëndësishëm. Zbatimi i teknikave të paprovuara të huadhënies në fusha të reja apo novatore të tregut, sidomos teknikat që nuk marrin në konsideratë parimet e shëndosha të kujdesit, ose standardet tradicionale lidhur me madhësinë e levës financiare, kanë çuar në lindjen e problemeve serioze në shumë banka.

Referencat

Crook, J. & Banasik, J. Does Reject Inference Really Improve the Performance of Application Scoring Models? Journal of Banking & Finance, Risk Management Group of the Basel Committee on Banking Supervision
Basel Committee on Banking Supervision Basel September 2000
Thomas, L. C., Edelman, D. B., Crook, J. N. Credit scoring and its applications.
Siddiqi, N. Credit risk scorecards: Developing and implementing intelligent credit scoring.



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI

President

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS, UET

Pastrimi i parave është procesi që konsiston në fshehjen apo devijimin ligjor të fitimeve, ose parave, që vijnë nga veprimtari të paligjshme me natyrë ilegale, mafioze e kriminale si: drogë, prostitucion, tregti armësh, para të fituara nga korrupsioni, spekulimet dhe mashtrimet financiare, informaliteti, shmangia e detyrimeve fiskale, etj. Qëllimi përfundimtar i pastrimit të parave është transformimi i këtyre parave në para të ndershme e të pastra, në fitime të ligjshme, e për pasojë, përdorimin normal të tyre në veprimtari ekonomik-financiare të ligjshme. Pastrimi i parave është aktualisht një fenomen mjaft i përhapur, por edhe po kaq në vëmendjen e shumë autoriteteve kombëtare e ndërkombëtare. Mjafton të përmendet fakti se, aktualisht sipas FMN-së, llogaritet se rreth 2-5% e PPB-së botërore qarkullon si para e pisët. Në shifra konkrete kjo do të thotë se, rreth 2.500-3.500 miliardë dollarë (PBB-ja botërore në 2014-ën ishte

Bankat dhe sistemi financiar përballë fenomenit të pastrimit të parave

Pyetja që shtrohet është: a ekziston një mënyrë e përgjithshme e njohur, një model standard se si pastrohen paratë, apo në çdo rast kemi të bëjmë me improvizime të ndryshme? Në këtë aspekt përgjigja është tashmë standarde. Pastrimi i parave ndjek një rrugë pak a shumë standarde, pavarësisht veçorive specifike të rasteve të ndryshme.

rreth 75.000 miliardë USD) sigurohet nga burime joligjore e kriminale.

Shprehja “pastrim parash” në kuptimin zyrtar të saj buron nga fakti se paraja e fituar ilegalisht, cilado qofshin mënyrat e saj, quhet “financë e zezë”, që përfshin veprimtari mafioze, kriminale, etj. “Pastrimi” i shërben këtyre parave që të jenë njësoj si paratë ligjore të ndershme, pra të mos kenë asnjë “njollë” kompromentuese. Shprehja “pastrim parash” filloi të bëhet pjesë e fjalorit të përditshëm në vitet ‘70 në kohën e skandalit “Watergate” në SHBA, ndërkohë që mori kuptimin dhe përmbajtjen e vërtetë ligjore në fillim të viteve ‘80. Nga pikëpamja historike ekzistojnë disa shpjegime për këtë shprehje. Ato e lidhin origjinën e shprehjes me një familje mafioze në Çikagon e viteve ‘20, e cila zotëronte një rrjet të gjerë lavanderish “Sanitary Cleaning Shops”, të cilën e përdorte si fasadë ligjore për të ricikluar, d.m.th. për të “pastruar” paratë e fituara nga veprimtari ilegale të të gjitha llojeve. Në mënyrë të hapur për këtë fenomen u fol gjatë procesit gjyqësor të Al Capone-s, i cili megjithëse kishte në CV-në e tij krime të shumta u dënua për mashtrime fiskale dhe pastrim parash, si edhe në proceset kundër mafiozëve si: Luçiano e Lanski në vitet 1930-40 në SHBA. Gjithashtu, në Europën

mesjetare të shek. XIII-XVI ekzistonin dy lloj monedhash: monedhat e arit dhe argjendit që shkëlqenin, me të cilat bëheshin pagesat kryesore dhe monedhave të metalit, që kishin vlerë të ulët dhe nxiheshin, me të cilat “mbaronte punë populli”, e që

Përvojat ndërkombëtare dhe studimet specifike kanë provuar se pastrimi i parave është fenomen negativ me pasoja të rënda afatgjata nëse tolerohet pasi: pengon zhvillimin e sektorit privat formal e ligjor, të cilin e përball me konkurrencë të pandershme; shkakton turbullira dhe paqartësi në flukset monetare dhe kursin e këmbimit në tregjet monetare; krijon destabilitet në tregjet financiare si dhe ul reputacionin e bankave dhe institucioneve financiare në përgjithësi, duke shkuar deri në provokimin e falimentimit apo krizave të rënda strukturore të tyre.

në shumicën e kohës ishin të pakontabilizueshme dhe pa statistika të qarta.

Pyetja që shtrohet është: a ekziston një mënyrë e përgjithshme e njohur, një model standard se si pastrohen paratë, apo në çdo rast kemi të bëjmë me improvizime të ndryshme? Në këtë aspekt përgjigja është tashmë standarde. Pastrimi i parave ndjek një rrugë pak a shumë standarde, pavarësisht veçorive specifike të rasteve të ndryshme. Së pari, “investimi” ose hedhja e parave në qarkullim, qoftë si investime, si depozita bankare, si transfera financiare, si çeqe kazinosh apo lojrash fati, etj, me një fjalë “futjen e tyre në sistemin financiar e monetar ligjor”. Së dyti, veçimi ose shkëputja e parave nga origjina dhe burimi fillestar i tyre dhe shpërndarja e qarkullimi i tyre nëpërmjet transaksioneve të ndryshme, ose siç quhen rëndom “montimeve financiare apo valsi i transfertave”, në mënyrë që të maskohet dhe të humbin gjurmët e origjinës. Këto lloj operacionesh bëhen me ndihmën e bankave, paraqsave fiskale, shoqërive financiare, shoqërive të sigurimeve, fondeve të investimit, transfertave spekulative të aksioneve, fitimeve, shpenzimeve, kazinove e lojrave të tjera të fatit, etj. Së treti, ribashkimi i këtyre parave në një ose disa pjesë, tashmë si “para të pastra” dhe legjitimimi i tyre si investime të ndershme në sfera si: pasuritë e patundshme, ndërtimi, fonde bamirësie, fonde investimesh, financime në fushën e sportit, modës dhe medias, investime në bursë, blerje objektivësh luksi, etj. Nëse flasim për improvizime, mund të thuhet se metodat moderne të pastrimit të parave sa vijjnë e bëhen më të sofistikuar e më komplekse, duke e vështirësuar natyrën kriminale apo antiligjore të tyre. Institucionet e specializuara ndërkombëtare si: FMN apo organizma të tjera ndërqeveritare, publikojnë rregullisht studime e tipologji ku tregohen teknikat dhe metodat e përdorura në sferën e pastrimit të parave. Asgjë nuk është më e panjohur. Çështja e pastrimit të parave është pjesë e globalizimit ekonomik, financiar e monetar, duke funksionuar në rrjete të mirëorganizuara.

Një fenomen specifik janë dhe “paraqsat fiskale”. Kriteret ndërkombëtare që i identifikojnë ato janë tre: taksat shumë të ulta apo mungesa totale e taksave; mungesa e çdo lloj transparence në siste-



Aktorët dhe institucionet monetare e financiare po formojnë kulturën institucionale dhe rregullin për të evidentuar dhe raportuar sipas kriterëve ligjore rastet që lidhen me veprimtari të pastrimit të parave. Shqipëria ka një ligj të veçantë “Për parandalimin e financimit të terrorizmit”. Pozitiv është fakti se në 2015-ën, Shqipëria nuk është më pjesë e grupit të vendeve që janë nën monitorim të vazhdueshëm për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.



min fiskal; dhe sekretin i plotë bankar e fiskal, duke mos bashkëpunuar me asnjë vend tjetër në këtë drejtim. Ekziston dhe një dallim ndërmjet paraqsave fiskale dhe paraqsave financiare, paraqsave bankare, paraqsat e investimeve, etj. Këtu futen ven-

det tipike “lavatrise parash”, deri te disa vende të zhvilluara, që tolerojnë aspekte të veçanta të pastrimit të parave. Aq fluide është kjo gjë, sa cdo shtet i veçantë boton listën e vendeve apo territoreve të dyshuara se zhvillojnë këtë veprimtari. Gjethia e parave të pista po kalon nga kapja e parave të pista me origjinë kriminale të mafies dhe bllokimit e riciklimit ligjor të tyre, në gjetjen e fitimeve të fshehura, fitime që vijnë nga klientelizmi politik, korrupsioni me pushtetin, shmangia e pagimit të taksave, transferimin e fondeve publike në veprimtari personale, etj. Në luftën në nivel ndërkombëtar që i bëhet procesit të pastrimit të parave, ende paraqsat fiskale dhe sofistikimet financiare krijojnë mundësi e hapësira për të zhvilluar një veprimtari të tillë.

Bankat kanë një rol të rëndësishëm në parandalimin e pastrimit të parave. Eksperiencat pozitive dhe ligjet specifike që ekzistojnë në këtë drejtim kërkojnë qartazi që bankat të raportojnë pranë agjencive apo strukturave të specializuara operacionet dhe identitetin e autorëve përkatës



të tyre që janë të dyshimtë; të deklarojnë operacione e transfertat në të cilët përfituesi i kapitaleve është i dyshimtë; të evidencojnë operacione jo-tipike financiare e monetare të individëve, organizatave apo bizneseve të cilat kanë të bëjnë me ndryshime të shpeshta statutore, pronësore e organizative të pajustificuara, apo me operacione financiare që nuk kanë lidhje me veprimtarinë e tyre ligjore të njohur deri në këto momente; të zbulojnë operacione të pajustificueshme të tipit transaksione në pasuri të patundshme me çmime “të çuditshme”, depozitime fondesh pa asnjë burim të njohur apo të justifikueshëm; të kenë programe speciale kontrolli të “praktikave më të mira” në veprimtarinë e tyre të përditshme, etj.

Në opinionin publik, por në disa raste dhe në mjediset institucionale apo akademike, ekziston mendimi se “mjafat vende kanë përfituar nga procesi i pastrimit të parave, sidomos kur nuk janë ato vetë vendi i origjinës së tyre”. Është e vërtetë se vendet “pritëse” apo “qarkulluese” të parave të pista mund të kenë përfitime

financiare, sidomos “operatorët ndërmjetës”, d.m.th. ata që realizojnë pastrimin. Rreth 20-25% e shumës së parave që pastrohen janë “shpërblimi” për këta operatorë ndërmjetës. Natyrisht që një pjesë e parave investohen si para të pastra në këto vende dhe supozohet se zhvillojnë ekonominë apo stimulojnë konsumin në këto vende. Përvojat ndërkombëtare dhe studimet specifike kanë provuar se pastrimi i parave është fenomen negativ me pasojat të rënda afatgjata nëse tolerohet pasi: pengon zhvillimin e sektorit privat formal e ligjor, të cilin e përball me konkurrencë të pandershme; shkakton turbullira dhe paqartësi në flukset monetare dhe kursin e këmbimit në tregjet monetare; krijon destabilitet në tregjet financiare si dhe ul reputacionin e bankave dhe institucioneve financiare në përgjithësi, duke shkuar deri në provokimin e falimentimit apo krizave të rënda strukturore të tyre; zvogëlon të ardhurat fiskale në vendet ku kryhet ky proces, pasi të ardhurat që vijnë nga aksione që kanë lidhje me pastrimin e parave zhvillohen në pjesën dërrmuese të tyre në informalitet; paraja e pisët e konvertuar në legjitime përdoret gjithnjë e më shpesh në veprimtari kriminale, informale apo si korrupsion për klasat politike e drejtuese ose menaxherët e lartë; paratë e pastruara përdoren për të krijuar pushtete paralele kriminale apo klienteliste jashtë tregut, qeverisjes, ligjit dhe qytetarëve, duke e bërë korrupsionin mjaft të fuqishëm; sa më lehtësisht të pastrohen paratë në një vend, aq më i madh është stimulimi për veprime informale, për shpërdorim pushteti, klientelizëm, shkelje ligjore, etj.; mjaft nga skandalet e mëdha financiare që kanë ndodhur në botë si: “Enron” në SHBA, “Parmalat” në Itali, “naftëmbajtësja Prestige” me kapital zviceran, “çështja Elf” në Afrikë, “çështja Glencore” e shumëkombëshe së çelikut, etj., kanë qenë raste të pastra operacionesh pastrimi parash të pista. Për këtë arsye, çështja e parandalimit të pastrimit të parave konsiderohet si “thembra e Akilit” për një kapitalizëm të shëndetshëm e të qëndrueshëm.

A është e imunizuar Shqipëria nga fenomeni i pastrimit të parave? Shqipëria ka disa “specifika” kur flitet për fenomenin e pastrimit të parave. Së pari, ashtu si shumë nga vendet e tjera ish-komuniste

lindore, ka vetëm pak më shumë se dy dekada që po ndeshet me këtë fenomen krejtësisht të ri për eksperiencën dhe traditat e saj. Si e tillë, në mjaft raste “është një pré e lehtë” për tu futur në kurth nga “ustallarët e vjetër” në këtë fushë. Së dyti, procesi i parandalimit të pastrimit të parave nuk është thjesht vullnet i mirë apo vendosmëri politike, por është i lidhur ngushtë me ngritjen dhe forcimin e institucioneve specifike për këtë qëllim, me përgatitjen e një sërë ligjesh, rregulloresh e masash specifike, të shoqëruara me kualifikimin e burimeve njerëzore të specializuara. Së fundi, vullneti për parandalimin apo zbulimin dhe dënimin e pastrimit të parave nuk duhet të jetë amator, selektiv, i përkohshëm, i politizuar, apo i keq-financuar, çka nënkupton se institucionet e specializuara në këtë drejtim duhet të kenë maksimumin e mbështetjes ligjore, politike dhe financiare. Problemi i rëndësishëm që ka të bëjë me cilësinë e zbulimit dhe parandalimit të pastrimit të parave, është kalimi nga dyshimet e arsyeshme të përcaktimi i lidhjes së drejtpërdrejt me veprën origjinuese nga rrjedhin paratë e pista.

Shqipëria ka një ligj të mirë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ka një strukturë të veçantë të inteligjencës financiare si: Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, të koordinuar me homologët dhe rregullatorët ndërkombëtarë, që bashkëpunon me autoritetet mbikëqyrëse, veçanërisht me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare. Aktorët dhe institucionet monetare e financiare po formojnë kulturën institucionale dhe rregullin për të evidentuar dhe raportuar sipas kriterëve ligjore rastet që lidhen me veprimtari të pastrimit të parave. Shqipëria ka një ligj të veçantë “Për parandalimin e financimit të terrorizmit”. Pozitiv është fakti se në 2015-ën, Shqipëria nuk është më pjesë e grupit të vendeve që janë nën monitorim të vazhdueshëm për pastrim parash dhe financim të terrorizmit. Ky është një nga përfundimet e raportit të grupit Onsite Team të ICRG. Shqipëria vlerësohet se ka plotësuar të gjitha mangësitë e raportuara në vite nga FATF (Financial Action Task Force), që monitoron zbatimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në botë.



Gjithçka, lehtësisht në dorën tuaj!

Bli çfarë dëshiron, dhe paguaj aq sa mundesh.



Karakteristikat kryesore të kartës së kreditit VISA GOLD:

- Pagesa minimale: 7% e vlerës së detyrimit mujor.
- Norma interesi dhe komisione konkurruese.
- Komision vjetor: 50% ulje për vitin e parë.

www.credit-agricole.al

 **CRÉDIT
AGRICOLE**

ALPHA BANK ALBANIA



Dita e Vullnetarëve

Në Ditën e Vullnetarëve, 17 maj 2015, banka organizoi një maratonë në Liqenin Artificial të Tiranës si dhe sponsorizoi fondacionin "Autizmi Flet Shqip". Rreth 60 punonjës të bankës vrapuan së bashku me më shumë se 40 vullnetarë të tjerë, nga fondacioni apo persona të famshëm. Slogani i fushatës ishte: "Vrapo për autizmin".

Dhurimi i gjakut

Për të pestin vit rradhazi punonjësit e Alpha Bank dhuruan gjak, në përgjigje të kërkesës së Kryqit të Kuq Shqiptar. Slogani ishte: "Së bashku ne dhurojnë jetë" dhe veprimtaria u shoqërua dhe me një fushatë në mediat sociale me mesazhin: "Unë dhuroj 5 minuta të kohës sime. Po ju?"

Gjatë tremujorit banka ka sponsorizuar këto veprimtari:

- Panairi "Ëndrra dhe Ide", 10 qershor, organizuar nga Ministria e Arsimit. Panairi kishte të bënte me idetë se si studentët e shohin rolin e shkollës, si një qendër e komunitetit.
- Edicionin e rradhës të Asamblesë së Përgjithshme të dhomës Amerikane të Tregtisë, më 27 prill 2015, ku u prezantua Indeksi i Biznesit të AmCham (ABI) dhe raporti Vjetor i saj nga z. Donald Lu, ambasador i SHBA-ve në Tiranë, dhe z. Arben Ahmetaj, Ministër i Ekonomisë.
- Rindërtimin e sheshit kryesor të Lushnjës, dhe konkretisht vendosjen e stolave.
- Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit me pajisje zyre.
- Pjesëmarrjen e grupit folklorik të Elbasanit "Skampa" në Folk Fest më 10 maj 2015, një sponsorizim ky i kërkuar nga Qendra Kulturore "Skampa" dhe Këshilli i Qarkut të Elbasanit.



BKT



Festivali për Fëmijë "Folk Fest" në Krujë

BKT mbështeti Festivalin e Këngës dhe të Valles Popullore për Fëmijë, i cili u zhvillua në Krujë më 29 maj, me pjesëmarrjen e artistëve të vegjël. Të ftuar nderi ishin artistë të mirënjohur të skenës dhe ekranit si: aktorja Tinka Kurti, sopranoja Edit Mihali si dhe personalitete të tjerë të fushave të ndryshme. Ky festival ka si qëllim ekspozimin e vlerave të këngës së vërtetë popullore shqiptare.



Bashkia e Tiranës – Qyteti i gjelbër

BKT synon të bëhet një bankë e gjelbër. Për këtë arsye, kohët e fundit janë implementuar shumë projekte për përmirësimin e mjedisit. Projekti me Bashkinë e Tiranës është përmirësimi i llullshes midis "Rrugës së Kavajës" dhe "Rrugës së Durrësit" duke mbjellë pemë, vendosur stola dhe kosha me qëllim shtimin e gjelbërimit dhe përmirësimin e mjedisit shlodhës të qytetit.



BKT vlerësohet me dy çmime të rëndësishme nga EMEA Finance

BKT është vlerësuar si "Banka Më e Mirë Lokale në Shqipëri" si dhe me Çmimin "Për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës për Europën Qendrore dhe Lindore e për Commonwealth-in e Shteteve të Pavarura" nga revista prestigjioze britanike: EMEA Finance, e cila shpërndan çdo vit çmimet për bankat dhe institucionet financiare më të mira në këto tregje. Çmimi "Banka Më e Mirë Lokale në Shqipëri", merret nga BKT për të pestin vit rradhazi.



CREDINS BANK




Tirana Open

Credins Bank mbështeti, për të dytin vit rradhazi, panairin e Librit dhe Artit. Përgjatë një jave qytetarë e Tiranës patën mundësinë të vizitonin: Panairin e librit, të organizuar në mjediset e Pallatit të Kongreseve; Tulla Center, për të gjithë dashamirësit e muzikës; operan: "Katër i Radës", pranë Universitetit të Arteve; Documentary Tirana International Film Festival, etj.

Ditët e Muzikës së Re

Festivali Ndërkombëtar "Ditët e muzikës së Re" mbërrin në edicionin e 18-të, duke promovuar muzikën bashkëkohore të kompozitorëve shqiptarë. Arti muzikor është pjesë e



pandashme e përgjegjësisë sociale që Banka Credins prej kohësh mbështet, duke kontribuar kështu në pasurimin e jetës kulturore në Shqipëri.

Festivali i 51-të i Fëmijëve

Banka Credins, për të dytin vit rradhazi, mbështeti Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë. Festivali i 51-të për Fëmijë është një veprimtari me përmasa të mëdha, për fëmijët e grupmoshave të ndryshme, organizuar nën kujdesin e kësaj qendre.

Qendrat Shëndetësore Lëvizëse

Banka vazhdoi mbështetjen e saj në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimit mjekësor në të gjithë vendin. Nëntë qendra të reja shëndetësore do të hapen për t'i ofruar shërbim mjekësor të gjithë turistëve që do të vizitojnë vendin, duke ofruar shërbim të pandërprerë gjatë gjithë sezonit.

Përgjegjshmëria Sociale

CREDIT AGRICOLE



Vijon bashkëpunimi CAA-EcoVolis

Për të tretin vit rradhazi banka vazhdon të bashkëpunojë me EcoVolis, shoqatën e sistemit alternativ të lëvizjes me biçikleta, nëpërmjet stacionit të përbashkët të biçikletave pranë Sheshit "Skënderbej" nën moton "Digj kalori, jo karburant".

Festa e Muzikës në Tiranë

Për të dytin vit rradhazi, Banka në bashkëpunim me Aleancën Franceze të Tiranës, risjellin organizimin e Festivalit Ndërkombëtar të Muzikës, këtë herë përmes tingujve të grupit të mirënjohur francez të rrymës pop "Pendentif", në një veprimtari të organizuar në sheshin "Nënë Tereza".



ICB



Banka Ndërkombëtare Tregtare zhvilloi shtatë ditë të dhurimit të gjakut për vitin 2015, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar, në ndihmë të fëmijëve talasemikë, të zhvilluar në mjediset e bankës, përkatësisht në datë 2 prill 2015.

Gjithashtu, Banka Ndërkombëtare Tregtare, për vitin e katërt rradhazi, ka dhënë kontributin e saj në donacione, në bashkëpunim me Fshatin SOS, ku vazhdon të sponsorizojë buxhetin e dy fëmijëve të këtij fshati, donacion ky i dhënë në Ditën e Donatorëve, të organizuar në mjediset e Fshatit SOS, më 20 maj 2015.



INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA



Shtatë Miliardë Ëndrra. Një Planet. Konsumoni me Përgjegjshmëri.

Dita Botërore e Mjedisit (DBM), e vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1972, demonstroi perspektivën njerëzore ndaj çështjeve të mjedisit. Festimet e DBM (WED) për vitin 2015 u organizuan në Ekspozitën Universale: Panairin "Expo Milano 2015" (01.05.2015-31.10.2015), ku Grupi Intesa Sanpaolo është partneri zyrtar global. Banka organizoi një fushatë dyjavore komunikimi e ndërgjegjësimi, dhe ndërmori disa nisma të brendshme si: nxitja e kolegëve për të bërë veprime të përditshme ekologjike si dhe organizimin e një ekskursion në një Fermë Bio.

Dhuroni gjak të shpëtoni një jetë!

Grupi i Dhuruesve Vullnetarë të Gjakut të ISBA organizoi nismën e rradhës në datat 21-22 maj në dy degët më të mëdha: pranë zyrave qendrore në Bllok dhe degën të Rr.Barrikadave, nën sloganin: "Gjaku nuk mund të krijohet në laborator, ai vetëm mund të dhurohet! Dhuroni gjak të shpëtoni një jetë!".

Ndihma për Fëmijët Jetimë

Punonjësit e bankës iu bashkuan thirrjes së Kryqit të Kuqit për të dhënë ndihmë, përmes dhurimit të rrobave e ushqimeve për fëmijët jetimë, me rastin e ditës së tyre më 20 maj dhe 1 Qershorit, Festës së Fëmijëve. Këto pako iu shpërndanë rreth 200 fëmijëve jetimë. Motoja e kësaj nisme ishte fjala e Nënë Terezës: "Ne s'mund të bëjmë dot gjëra të mëdha, vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe."

Nismë për Kursimin e Energjisë

Divizioni i Operacioneve ndërmori një nismë për Kursimin e Energjisë, duke promovuar veprimet e përditshme të përgjegjshme ndaj mjedisit, si psh: fikja e çdo pajisjeje që konsumon energji, sa herë që jemi jashtë zyrave.



NBG BANK ALBANIA




Mbështetje për Fshatrat e Fëmijëve SOS

Si pjesë e angazhimit ndaj komunitetit dhe njerëzve në nevojë, NBG Bank Albania bleu bileta për stafin e saj, për një veprimtari të organizuar me qëllim mbledhjen e fonde për Fshatrat e Fëmijëve SOS në Shqipëri. Kjo veprimtari u organizua nga Ambasada Austriake dhe Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, më 13 qershor, me pjesëmarrjen

z. Shkëlzen Doli, violinisti i mirënjohur.

Festimi me fëmijët jetimë në komunitet

Banka ishte pjesë e veprimtarisë së organizuar nga Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Tiranë, me rastin e 1 Qershorit, Festës së Fëmijëve. Veprimtaria mbledhi 100 jetimë që jetojnë në komunitet. NBG Bank Albania mbështeti këtë veprimtari, duke dhuruar dhurata për fëmijët.



PROCREDIT BANK



ProCredit Bank- Përgjegjës për të ardhmen!

Një përbërës thelbësor në misionin e zhvillimit të të gjithë grupit të bankave ProCredit, është mbrojtja e mjedisit. Të gjitha bankat simotra ProCredit kanë ndërmarrë një nismë të ngjashme dhe reale për reduktimin e përdorimit të plastikës, duke vënë në dispozicion të publikut 600 000 çanta Eko, që do të shpërndahen falas nga të gjitha bankat ProCredit. Rreth 30,000 çanta Eko janë shpërndarë në supermarkete, librari dhe në klientë të tjerë të ProCredit Bank. Në kuadër të nismës së ProCredit Bank: "ProCredit Bank, përgjegjëse për të ardhmen", u organizuan një sërë veprimtarish:

- Veprimtari argëtuese për fëmijët. Fëmijët e pranishëm ishin nxënës të shkollës 9-vjeçare private "Kristaq Rama", të cilët morën informacione për mbrojtjen e mjedisit dhe gjallesave të ndryshme. Më pas, të gjithë së bashku ndoqën teatrin për fëmijë, të luajtur në natyrë nga Trupa e Teatrit Kombëtar. Kjo atmosferë e gëzueshme u përcoll deri në fund të takimit, kur për mësuesit e pranishëm u pajisën me çanta Eko.
- Investime eficiente të energjisë në njësitë e biznesit dhe zyrat qendrore.
- Përdorim i Makinave hibride Eko nga këshilluesit e biznesit në operacionet e tyre të përditshme, duke reduktuar emetimin e gazeve të dëmshme në atmosferë.



RAIFFEISEN BANK



Raiffeisen Bank do të trajtojë punonjësit civilë për shërbimin ndaj klientit në Policinë e Shtetit

Raiffeisen Bank ka përkrahur nismën e Policisë së Shtetit për të trajtuar të rinjtë të përzgjedhur nga konkursi për punësim në zyrat e shërbimit të qytetarëve dhe operatorëve 129. Kjo nismë e Policisë së Shtetit u prezantua nga z. Saimir Tahiri, Ministër i Brendshëm. Në këtë ceremoni ishte i pranishëm edhe z. Christian Canacaris, Drejtor i Përgjithshëm i Raiffeisen Bank.

Dhurim gjaku për fëmijët talasemikë

Raiffeisen Bank, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar organizoi për të gjashtin vit rradhazi fushatën për dhurimin e gjakut për fëmijët talasemikë, me sloganin: "Të dhurosh gjak, do të thotë të japësh shpresë, të shpëtosh jetë. Kështu, kësaj fushate, të kthyer tashmë në traditë, iu bashkuan vullnetarisht punonjësit të Raiffeisen Bank, të cilët dhuruan gjak në ndihmë të këtyre fëmijëve, që sot numërohen të jenë rreth 600.



Përjeto çastin me kartën Fibank!

Apliko tani vetëm me kartë ID

- 0% interes, 0% komision për të gjithë vitin
- 4% ulje në çdo rezervim Hoteli



Fibank
First Investment Bank

Cilësia vjen e para.

TELEFONONI PA PAGESË NË
0800 01 11

www.fibank.al

SOCIETE GENERALE



Bashkëpunim me kompaninë ALEAT

Më 14 maj, 2015, gjatë “Javës Inovative”, në Tiranë, Banka Societe Generale Albania paraqiti një prezantim me temë: “Inovacioni në sigurinë dixhitale dhe eksperiencën e klientit”. Prezantimi paraqiste shërbime inovative, të bazuara në vërtetimin dixhital dhe në nënshkrimin elektronik të dokumenteve, nëpërmjet gjurmës së gishtit. Këto shërbime janë projektuar dhe krijuar duke përdorur platformën e besuar të Shërbimit eAleat, të shoqërisë ALEAT, një shoqëri e mirënjohur që operon me koncesion për prodhimin e kartave elektronike të identitetit dhe të pasaportave për qytetarët e Republikës së Shqipërisë, në emër të Ministrisë së Brendshme.

Dita e Donatorëve në SOS

Në eventin: “Dita e Donatorëve”, organizuar nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, që u zhvillua në 20 maj 2015, Societe Generale Albania dha kontributin e saj, jo vetëm në vlerë monetare, por u aktivizua edhe në ankanandin që SOS organizoi me pikturat e punuara nga fëmijët. Gjatë eventit, SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri rinovoi marrëveshjet ekzistuese jo vetëm me Societe Generale Albania, por edhe me disa partnerë të tjerë, si dhe firmosi edhe marrëveshje të reja.



TIRANA BANK



Në mbështje të fëmijëve të fshatit SOS, për një fëmijëri të lumtur

Tirana Bank mbështet Familjet SOS, të cilat ofrojnë kujdes të qëndrueshëm, në një mjedis familjar për fëmijët të cilët nuk jetojnë me familjen e tyre biologjike. Banka është angazhuar në “adoptimin” e tre fëmijëve të fshatit SOS dhe mundëson mbështetje të vazhdueshme për një kujdes të individualizuar dhe promovim për zhvillimin, edukimin, përkujdesjen shëndetësore, veprimtari sociale, sportive dhe argëtuese për këta fëmijë.



UBA



Mbështetje për familjet në zonat e përmytura në jug

Pas situatës kritike të familjeve të prekura nga përmytjet në jug të Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë (UBA) vendosi të bashkohet me nismën e Qeverisë Shqiptare, duke ndihmuar banorët e fshatrave periferikë të qytetit të Fierit, duke dhuruar shuma të barabarta monetare për 100 familje të prekura, në kuadër të ndihmave humanitare.

Sponsor për integrimin e fëmijëve jetimë shqiptarë

Banka mbështeti programin e paraqitur nga "Instituti Kombëtar i Integritit të Fëmijëve Jetimë në Shqipëri", zhvilluar në 20 maj 2015, në Tiranë. Shumë përfaqësues të shquar nga qeveria, trupi diplomatik, biznesi dhe shoqëria civile morën pjesë në këtë veprimtari, që edhe njëherë tjetër na kujtoi se: "Përtej dhimbjes, ka dashuri".





nga Zj. Blerta KOÇI

Pergjegjëse e Sektorit IT
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Ngritja dhe jetësimi i Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim është një prej nis-mave më të rëndësishme që Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) ka realizuar gjatë vitit 2014. Një nga mësimet e nxjerra nga kriza financiare globale e vitit 2008 ishte mungesa e sistemeve informatike në dispozicion të siguruesve të depozitave. Sistemet informatike mundësojnë kryerjen me efikasitet të një procesi kompensimi, i cili rimbursos në mënyrë të shpejtë dhe të saktë depozituesit e siguruar. Në këtë kuadër, me qëllim përm-bushjen e objektivave kryesorë të skemës së sigurimit të depozitave, kompensimin e depozituesve duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, ASD-ja ndërromi pikërisht nismën e informatizimit të procesit të raportimit dhe kompensimit.

Në përputhje me planin e projektit, ndërtimi i sistemit nisi në muajin korrik 2013 dhe përfundoi me sukses në gusht

Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim (SIRK) në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave

|| SIRK mundëson akses të menjëhershëm dhe në çdo kohë të të dhënave nga ASD-ja, për identifikimin e depozituesit në mënyrë unike në sistem nëpërmjet të dhënave të tij personale; kjo lejon përcaktimin dhe vlerësimin e saktësisë së të dhënave personale të depozituesve në regjistrat elektronikë të subjekteve anëtare të skemës dhe të shumës së siguruar, që ASD duhet t' i kompensojë depozituesit në rast ngjarje sigurimi. **■ ■ ■**

të 2014-ës, duke u përdorur për herë të parë nga bankat për përllogaritje primi në muajin tetor të vitit 2014. Objektivi kryesor i SIRK-ut është qendërzimi i informacionit elektronik të raportuar nga bankat në ASD, përllogaritja e primit për secilën bankë dhe kompensimi i shpejtë dhe efektiv, në rast ngjarje sigurimi. Ky projekt është realizuar me mbështetjen financiare të një granti nga BERZH-i (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim) dhe me asistencën e FDIC-së (Federal Deposit Insurance Corporation), përmes konsulencës teknike të ekspertëve të nivelit të lartë në hartimin e termave të referencës dhe vlerësimit të ecurisë së tij.

Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim mundëson akses të menjëhershëm dhe në çdo kohë të të dhënave nga ASD-ja, për identifikimin e depozituesit në mënyrë unike në sistem nëpërmjet të dhënave të tij personale. Kjo lejon përcaktimin dhe vlerësimin e saktësisë së të dhënave personale të depozituesve në regjistrat elektronikë të subjekteve anëtare të skemës dhe të shumës së siguruar, që ASD duhet t' i kompensojë depozituesit në rast ngjarje sigurimi. Në këtë mënyrë, SIRK-u bën të mundur përqendrimin e informacionit në dispozicion të ASD-së, lidhur me depozi-

|| Për të garantuar përditësimin e vazhdueshëm të skedarëve të sistemit me të dhënat e shumës së sigurimit dhe primin që duhet të paguhet nga bankat, sistemi i raportimit parashikon një frekuencë mujore për të dhënat e llogarive të lidhura me depozitat individuale në bankë, dhe të dhënat e detajuara të depozituesit që e identifikojnë saktësisht atë. **||**

tat dhe depozituesit, mbi baza individuale dhe/ose të agreguara. Ndër të tjera, SIRK ndihmon gjithashtu ASD-në të vlerësojë saktësinë e përllogaritjes së primit periodik, të raportuar nga subjektet anëtare të skemës.



RREGULLAT E RAPORTIMIT ELEKTRONIK

Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim i ASD-së funksionon në bazë të raportimit të të dhënave nga aktorët e përfshirë në këtë proces. Për këtë arsye, përcaktimi i qartë dhe i saktë i rregullave të raportimit u identifikua si domosdoshmëri nga strukturat e ASD-së. Kështu, Këshilli Drejtues i ASD-së miratoi në muajin nëntor 2014 “Udhëzimin për Bankat”, me qëllim ndërveprimin në nivel teknik dhe ligjor me bankat e nivelit të dytë, të cilat janë dhe përdoruesit kryesorë të Sistemit Informatik për Raportim dhe Kompensim. Udhëzimi, i cili u nënshtrua paraprakisht konsultimeve dhe diskutimeve me të gjitha bankat e nivelit të dytë, përcakton rregullat e raportimit që shtrihen në dy nivele:

- (i) verifikimi i saktësisë së primit që bankat raportojnë në ASD, dhe
- (ii) gatishmëria e të dhënave të depozituesve, në rast ngjarje sigurimi apo në kryerjen e një simulimi.

Për të garantuar përditësimin e vazhdueshëm të skedarëve të sistemit me të dhënat e shumës së sigurimit dhe primin që duhet të paguhet nga bankat, sistemi i raportimit parashikon një frekuencë mujore për të dhënat e llogarive të lidhura me depozitat individuale në bankë, dhe të dhënat e detajuara të depozituesit që e identifikojnë saktësisht atë. SIRK gjithashtu parashikon një frekuencë raportimi tremujore për primin e përllogaritur për çdo depozitues të siguruar në

secilën bankë të sistemit.

Në rastin e një ngjarje sigurimi apo të një procesi simulimi, duke marrë në konsideratë që shpejtësia dhe saktësia e identifikimit të depozituesve të siguruar dhe shumave përkatëse është e një rëndësie parësore, frekuenca e raportimit do të jetë ditore për këtë kategori të dhënash. Në këto raste, të dhënat të mësipërme ju shtohen edhe të dhëna të detajuara mbi huat e lidhura me depozitat, që janë vënë si garanci për këto kredi, si dhe pozicionin e netuar të depozituesit. Për më tepër, ASD-ja ka të drejtë të kërkojë raportim nga bankat në çdo moment për qëllime të veçanta dhe të paparashikuara, me qëllim zbatimin e objektivave publikë të veprimtarisë së saj.

BASHKËVEPRIMI ME ANËTARËT E SKEMËS SË SIGURIMIT

Ngritja dhe funksionimi efikas i sistemit, për të përmbushur të gjithë objektivat e përcaktuar, kërkon bashkëpunimin dhe bashkërendimin e të gjitha aksioneve me palët e përfshira në proces. Koordinimi, me qëllim pranimin e të gjitha tipareve dhe elementëve përbërës, është një garanci për suksesin e procesit. Në këtë këndvështrim, ASD-ja ka bashkëpunuar konkretisht dhe në vazhdimësi gjatë të gjitha fazave të vënies në zbatim të sistemit me të gjitha bankat. Për këtë janë organizuar, ndër të tjera, seminare, trajnime dhe testime të sistemit SIRK me bankat, të cilat kanë synuar evidentimin e funksioneve kryesore të këtij sistemi dhe të sfidave që dalin për zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të SIRK nga këndvështrimi i sektorit bankar.

SEMINARI: “AKTIVIZIMI I SISTEMIT TË AUTOMATIZUAR PËR MBLEDHJEN DHE RAPORTIMIN E TË DHËNAVE”.

Në prag të nisjes së raportimit on-line nga bankat, në muajin shtator të vitit 2014, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, si një nga institucionet e para të sigurimit të depozitave në rajon që vë në zbatim një sistem informatik për raportim dhe kompensim, organizoi seminarin me temë “Aktivizimi i Sistemit të Automatizuar për Mbledhjen dhe Raportimin e të Dhënave”. Seminari synonte të prezantonte funksionet kryesore të sistemit, ndikimin e tij në përmirësimin e proceseve të punës për Agjencinë dhe bankat, ndryshimet rregullative në vijim të miratimit të Ligjit të ri “Për sigurimin e depozitave”, si dhe të theksonte detyrimin e bankave për të zbatuar në mënyrë të menjëhershme kërkesat e Agjencisë për raportimin e të dhënave.

Duke marrë në konsideratë faktin që disa prej bankave kishin dhënë kontributin e tyre në fazat e testimit të sistemit, seminari ishte një mundësi për prezantimin e këtyre eksperiencave dhe sfidave që dalin për zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të SIRK nga këndvështrimi i sektorit bankar. Seminari u ndoq nga drejtorë të përgjithshëm, drejtues të departamenteve të Infrastrukturës së Teknologjisë dhe departamenteve Operacionale të bankave të nivelit të dytë, si dhe delegacione të nivelit të lartë të Fondeve të Sigurimit të Depozitave të Kosovës dhe Malit të Zi.

LLOGARI NË RMB

Gold Member of



SHQIPËRI



KINË



NJË LLOGARI NË VALUTË KINEZE!

Administro më mirë
kapitalin e biznesit tënd

开立中人民币账户。改善你的企业资金管理。

与中国做生意变得比以往更容易!

**BIZNESI ME
KINËN BËHET
MË I THJESHTË
SE KURRË!**

- Eliminoni risqet dhe tarifat e një këmbimi valutor të huaj.
- Eliminoni ndërmjetësit dhe kryeni veprime të thjeshta dhe të shpejta.
- Hap një llogari në RMB dhe transferoni paratë tuaja në Kinë thjesht, shpejt dhe pa burokraci.

WWW.ICB.AL



04 22 56 254



INTERNATIONAL COMMERCIAL BANK

rëndësi kanë vlerat





nga Prof. Asoc. Dr. Rovena BAHITI
Drejtoreshë
AGJENCIA KOMBËTARE PËR SIGURINË
KOMPJUTERIKE (ALCIRT)

Të gjithë jetojmë një jetë dixhitale, punojmë, mësojmë dhe luajmë online. Interneti është një burim i përbashkët dhe sigurimi i tij duhet të jetë gjithashtu një përgjegjësi e përbashkët. Për këtë arsye siguria kibernetike fillon nga gjithsecili prej nesh, nga çdo punonjës në sektorin privat apo administratën shtetërore, një mësues apo një student, një bankier apo një polic, pasi të gjithë do të ndikohemi dhe do të ndikojmë në sigurinë e hapësirës kibernetike. Asnjë individ, biznes apo ent qeverisje nuk është i vetëm përgjegjës për sigurinë në internet. Gjithkush ka një rol në sigurimin e pjesës së tij/saj të hapësirës kibernetike, duke përfshirë pajisjet dhe rrjetet që përdor. Veprimet individuale kanë ndikim kolektiv, prandaj kur ne e përdorim internetin në mënyrë të sigurt, e kemi bërë atë më të sigurt për të gjithë.

Shqipëria renditet ndër vendet ku zhvillimi i telekomunikacionit, qasja në

Rëndësia e sigurisë kibernetike dhe roli i ALCIRT-it

Shqipëria renditet ndër vendet ku zhvillimi i telekomunikacionit, qasja në internet dhe informatizimi i shoqërisë po përparon shumë shpejt. Rritja e përdorimit të komunikimit elektronik përbën një vlerë të shtuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, por në të njëjtën kohë, ajo e ekspozon atë ndaj rreziqeve të natyrës kibernetike, me aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë.

internet dhe informatizimi i shoqërisë po përparon shumë shpejt. Rritja e përdorimit të komunikimit elektronik përbën një vlerë të shtuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit, por në të njëjtën kohë, ajo e ekspozon atë ndaj rreziqeve të natyrës kibernetike, me aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë. Numri i shkeljeve të sigurisë së rrjeteve dhe sigurisë së informacionit është duke u rritur me shpejtësi. Sulmet kibernetike kanë potencial për të dëmtuar rëndë shkëmbimin e informacionit në institucionet publike, të telekomunikacionit dhe sistemin financiar e bankar, duke shkaktuar humbje financiare dhe ndërprerje të shërbimeve jetike. Këto sulme krijojnë rreziqe dhe kërcënime të reja për zhvillimin e shoqërisë së informacionit.

Në këtë kuadër, u pa e domosdoshme të ndërmerren disa hapa për zhvillimin e sigurt të shoqërisë së informacionit. Pikerisht krijimi i Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT), ishte një nga hapat në përgjigje edhe të kërkesave të kohës, lidhur me standartet e sigurisë. ALCIRT u krijua me VKM Nr.766, dt. 14.09.2011 dhe u ngrit me mbështetjen e programit të USAID (Albanian Cyber-Security Program), një nismë dyvjeçare në ngritjen e kapaciteteve të

qeverisë shqiptare për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur incidenteve kompjuterike. Projekti shfrytëzoi ekspertizën e Universitetit Carnegie Mellon Software Engineering Institute (SEI), i cili kreu disa seminare dhe trajnime për të ndihmuar institucionet kryesore qeveritare dhe jo vetëm, të kuptonin modelet për sigurinë

Sulmet në infrastrukturën kritike të informacionit në rang vendi mund të kenë pasoja të rënda në funksionalitetin e tyre, duke shkaktuar edhe humbje të mëdha financiare, prandaj lind nevoja që së pari ato të identifikohen e më pas të merren masa të forta sigurie për ta mbajtur në nivel më të lartë sigurinë e këtyre infrastrukturave si më jetike për funksionimin e shoqërisë.

kibernetike, për të ndërtuar aftësitë për t'i bërë ballë kërcënimeve operative, si dhe për të zhvilluar proceset për menaxhimin e incidenteve kompjuterike.

Objekti i veprimtarisë së ALCIRT është identifikimi, parashikimi dhe marrja e masave për mbrojtjen ndaj kërcënimeve dhe sulmeve kompjuterike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. ALCIRT është autoriteti që bashkërendon punën për përgjigjet dhe kundërmasat ndaj kërcënimeve/sulmeve kompjuterike dhe shërben si pika qendrore e kontaktit me NATO-n dhe institucionet analoge (CIRT-et sektoriale dhe ndërkombëtare). Bashkëpunimi i vazhdueshëm me NATO-n do të sjellë padyshim përafrimin e vendit tonë në këtë drejtim, me vendet e tjera anëtare të NATO-s.

ANGAZHIMET AKTUALE TË ALCIRT

Në vijim paraqiten shkurtimisht disa nga angazhimet e ALCIRT-it, në përpjekjen e vazhdueshme për të krijuar një hapësirë të sigurt për qytetarët, biznesin dhe qeverinë.

Agjencia ka kryesuar Grupin Ndërinstitucional të Punës, nën kujdesin e Ministrisë të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike znj. Harito, për hartimin e Dokumentit të Politikave për Sigurinë Kibernetike. Ky dokument, i pari në këtë fushë, mbështetet në modele dhe praktikat më të mira europiane, përvoja të parashikuara, gjithnjë duke marrë në konsideratë karakteristikat specifike të shoqërisë dhe ekonomisë shqiptare. Në këtë Dokument, rëndësi të veçantë i është kushtuar infrastrukturave kritike. Sulmet në infrastrukturat kritike të informacionit në rang vendi mund të kenë pasojat të rënda në funksionalitetin e tyre, duke shkaktuar edhe humbje të mëdha financiare, prandaj lind nevoja që së pari ato të identifikohen e më pas të merren masa të forta sigurie për ta mbajtur në nivel më të lartë sigurinë e këtyre infrastrukturave si më jetike për funksionimin e shoqërisë.

Meqenëse këto sisteme, në pjesën më të madhe të tyre nuk janë shtetërore, por i përkasin sektorit privat, në mënyrë të vazhdueshme ALCIRT nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit me këtë sektor, e veçanërisht atë bankar, për të garantuar sigurinë bazë të këtyre

sistemeve. Përveç mbrojtjes së këtyre sistemeve, është kritike edhe “aftësia ripërtëritëse” (resilience), e cila mundëson garantimin e vazhdueshmërisë së biznesit, në rastet e ndodhjes së forcape madhore apo të sulmeve të ndryshme kibernetike. Mbrojtja dhe aftësia ripërtëritëse e infrastrukturave kritike si dhe inkurajimi i operatorëve që i zotërojnë ato për vënien në jetë të një arkitekture sigurie të plotë (përfshirë menaxhimin e rrezikut dhe të emergjencave) do të garantonte efektivitetin, besueshmërinë dhe vazhdueshmërinë e shërbimeve të ofruara prej tyre.

Rëndësi të veçantë merr iniciimi i ndryshimeve ligjore, në mënyrë që të ofrohet mbrojtje e përshtatshme për përdoruesit, për të rritur besimin e tyre në



Sulmet kibernetike kanë potencial për të dëmtuar rëndë shkëmbimin e informacionit në institucionet publike, të telekomunikacionit dhe sistemin financiar e bankar, duke shkaktuar humbje financiare dhe ndërprerje të shërbimeve jetike. Këto sulme krijojnë rreziqe dhe kërcënime të reja për zhvillimin e shoqërisë së informacionit.



teknologjitë e informacionit dhe për të inkurajuar përdorimin e avancuar dhe të sigurt të TIK-ut. Pas miratimit të bazës ligjore/rregullative për të cilën jemi duke punuar, operatorët e infrastrukturave kritike do të duhet të raportojnë mbi incidentet e rënda kibernetike. Për çdo rast (të evidentuar ose jo) si krim kibernetik do të bëhet analiza e tij, shkaqet e ndodhjes dhe nxjerrja e detyrave që duhet të pasqyrohen në akte ligjore, apo rregullore e procedura, për eliminimin e përsëritjes së tyre. Njerëzit janë çelësi i suksesit, prandaj do të nxisim çertifikimin e profesionistëve të sigurisë, si dhe pavarësinë e tyre funksionale nga njësitë

e teknologjisë së informacionit, për t'i kaluar ata në varësi të drejtpërdrejtë të CEO-ve. Po ashtu, vlerësohet si tejet e nevojshme marrja e veprimeve dhe masave specifike, për të ndërgjegjësuar shoqërinë lidhur me rreziqet e mundshme në fushën e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve, eliminimin e këtyre rreziqeve, përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e paligjshme në hapësirën kibernetike.

ALCIRT, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASP), ka organizuar për herë të parë trajnimin: “Siguria Kompjuterike” për punonjësit IT të Administratës Publike, me qëllim forcimin e institucioneve nëpërmjet rritjes së kapaciteteve teknike të burimeve njerëzore, Trajnimi ka filluar në muajin Shtator të vitit të kaluar e do të pasohet nga module më të avancuara trajnimi për specialistët e sigurisë. ALCIRT ka ndërmarrë fushata ndërgjegjësimi me studentët e universiteteve publike e private me drejtim TIK, me qëllim edukimin e tyre si përdorues të sotëm e profesionistë të nesërm.

ALCIRT ka menduar edhe për publikun e gjerë, duke ngritur portalin ndërgjegjëses (www.cyberalbania.al), qëllimi i të cilit është të edukojë dhe të promovojë një shoqëri dixhitale të sigurt, duke përdorur internet të sigurt në shtëpi, punë dhe shkollë. Gjithashtu, kemi ngritur ura bashkëpunimi me institucione të tjera që operojnë në këtë fushë, duke përmendur marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike e Postare si dhe Policinë e Shtetit. Nga ana tjetër, në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA), kemi futur në kurrikulat e arsimit parauniversitar tema që trajtojnë sigurinë online.

Së fundi, do të doja të falënderoja akademinë dhe sektorin privat, në veçanti Komitetin e Sigurisë së Informacionit pranë Shoqatës Shqiptare të Bankave, pasi përfaqësues të tyre gjithmonë e kanë mbështetur ALCIRT-in në nismat e saj. Kam bindjen e plotë se duke punuar së bashku do të mund të krijojmë një hapësirë kibernetike të sigurt, të besueshme e të qëndrueshme për qytetarët, biznesin dhe qeverinë.



nga Zj. Bianca DURO

Drejtoare e Training Institute
WIFI ALBANIA¹

MENAXHIMI MODERN I PROJEKTEVE: OKSIGJENI I BIZNESIT TË SOTËM

Biznesi në rrafsh global gjatë vitit 2015, përfundimisht nuk duket në ditët e tij më të mira. Rritja e përgjumur ekonomike vazhdon, duke e vënë theksin mbi faktin se si organizatat ekzekutojnë nismat e tyre strategjike. Nga ana tjetër, kjo kërkon një menaxhim më rigoroz të projekteve, programeve dhe portofoleve. Megjithatë, gjatë viteve të fundit, shumë nga gjetjet rreth faktit se sa mirë organizatat po jetësojnë nismat e tyre strategjike, kanë mbetur kryesisht të pandryshuara. Kjo na jep të drejtën të ngremë pyetjen se "si" organizatat mund të jetësojnë projekte të mirë-menaxhuar dhe të ndjekin nismat strategjike.

Fakti që shumë firma përballen aktualisht me humbje dhe me shumë mangësi sugjeron se tashmë është koha që organizatat të rishqyrtojnë bazat e menaxhimit të projekteve çka në thelb, do të thotë një rikthim të rrënjët e argumentit. Menaxhimi i projekteve nuk është një praktikë e re e brezave modernë. Gjatë gjithë historisë së tij, që nga kohërat e lashta, menaxhimi i projekteve ka

Zbatimi i artit dhe shkencës së menaxhimit të projekteve në biznesin e sotëm

Menaxhimi i projekteve synon përmirësimin e ecurisë së një organizate biznesi. Kjo është një disiplinë që kombinon mjeshtëritë teknike, mjetet dhe aftësitë njerëzore. Shumë shoqëri angazhohen në një projekt të caktuar, pasi ato besojnë se kjo është jetike për të qenë konkurruese në industrinë ku bëjnë pjesë; nevojat në ndryshim e sipër të klientëve të tyre duhet të plotësohen.

qenë në themel të gjitha sipërmarrjeve, qofshin këto të mëdha apo të vogla, duke u kthyer kështu në një art dhe shkencë, që synon gjithnjë përsosmërinë. Megjithatë, në botën e sotme të biznesit, menaxhimi i projekteve është zhvilluar në atë pikë ku është kthyer në zgjidhjen kyçe dhe kryesore për çdo operacion biznesi.

NDRYSHIMI, E VETMJA KONSTANTE QË TË ÇON DREJT SUKSESIT

Shumë gjetjet shkencore kanë mbetur të pandryshueshme gjatë katër viteve të fundit, duke mos treguar ulje, apo ngritje të rëndësishme. Po pse nuk po lëvizin këto shifra? Çfarë e shkakton ndryshimin e dukshëm?

Raporti PULSE of the PROFESSION i PMI-së, tregon se organizatat e suksesshme i përmbushin qëllimet e tyre dy herë e gjysmë më shpesh dhe shpenzojnë 13 herë më pak para' sesa homologët e tyre (Project Management Institute, Chapter Austria, 2015). Ky realitet, i raportuar çdo vit nga studimi i PULSE, tregon vlerat që ka menaxhimi i projekteve - e që nga në gjetjet e këtij viti, kuptohet plotësisht nga më shumë se gjysma e të gjitha organizatave (55%). Paçka se ky mund të duket një lajm i mirë, duhet theksuar se numri i organizatave që e njohin dhe e përvetësojnë një vlerë të tillë ka mbetur i pandryshuar, që nga viti 2012, kështu që ka ende shumë punë për të bërë.

Kultura - Organizatat më efektive e njohin nevojën e ekzistencës formale të menaxhimit të projekteve dhe programeve, në kuadër të nismave të tyre për "ndryshimet në bi-

znes". Krijimi i një kulture që përfshin menaxhimin e projekteve dhe rrit vlerën biznesit që ky menaxhim prodhon, përfshin:

- Të kuptuarit e plotë të vlerës së menaxhimit të projektit,
- Kërkesën për një angazhim aktiv të sponsorëve ekzekutivë lidhur me projektet dhe programet,
- Bashkërendimin e projekteve dhe programeve me strategjinë e organizatës,
- Disponimin e një menaxhimi projektsh, programesh dhe portofoli, tërësisht të maturuar.

Talenti - Një faktor kyç në nxitjen e një kulture që vlerëson menaxhimin e projekteve është të kuptuarit e rëndësisë së talenteve të kualifikuar. Sipas anketës globale të PMI-së dhe EIU-së për vitin 2014: Rally the Talent to Win: Transforming Strategy into Reality, vetëm 17 për qind e të anketuarve pohojnë se strategjitë e tyre të menaxhimit të talenteve reagojnë shpejt ndaj ndryshimit në kushtet e biznesit, ndërsa për një të tretën e tyre, përgjigja efektive ndaj ndryshimit kërkon 2-3 vjet, ose më gjatë. Një dobësi e tillë kaq e përhapur ka dhe pasojat e saj: mesatarisht, për të gjitha shoqëritë e anketuara, mangësitë në talente pengojnë në mënyrë thelbësore rreth 40 për qind të përpjekjeve për zbatimin e strategjisë.

Procesi - Kërkimet e viteve të fundit kanë konfirmuar se, organizatat mund të përfitojnë qartësisht nga maturimi i proceseve të tyre të menaxhimit të projekteve, programeve dhe portofoleve dhe se vet ma-

¹ Partner i PMI- Chapter Austria në Shqipëri

MBESHTESIM RISITE

NE AGROBIZNES



INTESA SANPAOLO BANK

MBESHTESIM RISITE NE AGROBIZNES ME AGRO-KAPITAL QARKULLUES DHE AGRO-INVESTIM.
SERAT, NJE POTENCIAL I MADH PER T'U EKSPLORUAR.

NJE BOTE MUNDESISH REALE

Intesa Sanpaolo Group
Official Global Partner



MILANO 2015

CALL CENTER
08006000 (FALAS)
Tel. +355 4 2276000
Cel. +355 692080903

www.intesasanpaolobank.al

BANK OF INTESA SANPAOLO GROUP
INTESA  SANPAOLO

turimi i proceseve çon drejt suksesit. Gjetjet më të fundit tregojnë se organizatat me ecuri shumë të lartë e mbështesin menaxhimin e projekteve, programeve dhe portofoleve, nëpërmjet përdorimit të praktikave të standardizuara të menaxhimit të projekteve, përgjatë gjithë organizatës. Përveç kësaj, projektet e tyre janë tejet të bashkërenduar me strategjinë e organizatës. "Unë nuk e veçoj zbatimin e strategjisë nga sukcesi i projektit," pohon Daniel Svoboda, Menaxher i Programit, PMP, Key Bank. "Çdo projekt i një shoqërie, në një farë mënyre, duhet të bashkërendohet me strategjinë."

Transferimi i njohurive - Transferimi i njohurive, që nga kapja dhe përdorimi i mësimave të nxjerra deri te zbutja e ndikimit negativ që ka humbja e stafit me përvojë, përfaqëson një kompetencë organizative shumë kritike - por shpesh të nënvlerësuar. Një studim i kohëve të fundit arrin në përfundimin se pak organizata janë veçanërisht efektive në transferimin e njohurive. Që transferimi i njohurive të bëhet rutinë, por efektiv, duhet që të ai të jetë i rënjosur kulturash. Kërkimi pohon gjithashtu se, organizatat me ecuri shumë të lartë e njohin nevojën për t'u fokusuar në zhvillimin dhe trajnimin e talentëve, për të arritur një zbatueshmëri të shkëlqyer të projekteve dhe përbushje të nismave strategjike.

Menaxhimi i rrezikut - Menaxhimi i rrezikut qëndron në zemër të menaxhimit të projekteve. Çdo projekt mund të përballet me një sërë rreziqesh që mund ta nxjerrin atë tërësisht janë binarëve, shpesh jo për faj të ekipit të projektit. Kërkimi tregon se 64 për qind e organizatave raportojnë një përdorim të shpeshtë të praktikave të menaxhimit të rrezikut, me një rënie nga niveli i lartë prej 71 për qind, të shënuar në vitin 2012. Pavarësisht rënies, e cila është diçka që do të monitorohet në vijim, studimi gjen se 83 për qind e organizatave me ecuri të lartë raportojnë një përdorim të shpeshtë të praktikave të menaxhimit të rrezikut, krahasuar me vetëm 49 për qind të atyre me ecuri të dobët.

Zhdërvjelltësia organizative - Zhdërvjelltësia organizative është aftësia e një biznesi për të reaguuar dhe përshtatur shpejt ndaj ndryshimeve në treg, ose në pjesë të tjera të mjedisit të jashtëm të saj. Përdorimi i mjeteve dhe teknikave të zhdërvjellta, graduale dhe përsëritëse të menaxhimit të projekteve është tejet i rëndësishëm në skenarë të tillë, pasi ato ndikojnë në projekte dhe programe, ndërkohë që përdorimi i këtyre mjeteve dhe teknikave është gjithnjë e në rritje.

Në sektorin bankar, shumë banka po vijojnë me projekte të mëdha lidhur me efikasitetin e kostos, menaxhimin e rrezikut dhe integrimin e sporteve, që nënkupton se kërkesa e lartë për menaxherë projektsh



nuk po tregon aspak shenja rënieje. Menaxherët e projekteve janë në kreshtë të dallgës së jashtëzakonshme të kërkesave nga ana e bankave për të përballuar ndryshimet rregullatore, sfidat e integritit dhe nevojat e vazhdueshme për eficiencë operationale. "Pjesa dërrmuese e veprimtarisë së menaxhimit të projekteve ende nxitet nga sfidat e integritit, që shoqëron veprimtarinë e shkrirjeve dhe bashkimeve, pas krizave", thotë Mark Weller, drejtor i Hays Projects & Change. "Gjithsesi, ekzistojnë dhe trysni rregullatore, që lidhen me projektet e përpunueshmërisë me standardet e Bazelit, FSA-së, si dhe rregulloret "Njih-Klientin-Tënd (KYC)" dhe ato të parandalimit të pastrimit të parave (AML). Bankat e investimeve, në veçanti, po rekrutojnë personel për të drejtuar projekte që lidhen me ndryshimet në rreziqet e kredisë dhe të tregut, si dhe nismat e integritit të sporteve të tyre."

Nisur nga natyra relativisht e fundme e këtyre projekteve, është e kuptueshme që pjesa dërrmuese e këtyre rekrutimeve janë të kontraktuar (pra të jashtëm). Megjithatë, ai sugjeron se, për shkak të nevojës së vazhdueshme për menaxherë projektsh dhe mungesës relative të kandidatëve me përvojë, bankat po punësojnë gjithnjë e më shumë personel të përhershëm.

Menaxhimi i projekteve synon përmirësimin e ecurisë së një organizate biznesi. Kjo është një disiplinë që kombinon mjeshtëritë teknike, mjetet dhe aftësitë njerëzore. Shumë shoqëri angazhohen në një projekt të caktuar, pasi ato besojnë se kjo është jetike për të qenë konkurrese në

industrinë ku bëjnë pjesë; nevojat në ndryshim e sipër të klientëve të tyre duhet të plotësohen. Nevoja për menaxhimin është gjithashtu e nevojshme, në mënyrë që procesi i organizatës të mund të bëhet më efikas, duke iu përshtatur ndryshimeve në mjedisin global.

Menaxherët dhe punonjësit e tjerë, që marrin pjesë në trajnimin rreth menaxhimit, mësojnë teknikat që duhen përdorur për përmirësimin e aftësive të tyre. Nëse jeni menaxher dhe ndiqni një kurs menaxhimi projektsh, do të mësoni bazat e menaxhimit si dhe do të përmirësoni aftësitë e veçanta, si: vlerësimi i kostos, planifikimi dhe menaxhimi i rrezikut. Gjithashtu, do të përfitoni njohuri mbi liderhipin dhe menaxhimin e njerëzve të tjerë. Pasi merrni certifikatën në menaxhim, do të jeni shumë i vlerësuar nga shoqëria për të cilën punoni, e zakonisht mund të kërkonti një pagë më të lartë, pikërisht për shkak të aftësive tuaja të specializuara.

Përfitime kanë edhe firmat, të cilat kanë punonjës që ndjekin trajnime rreth menaxhimit, sepse atëherë ato do të kenë më shumë kontroll mbi projektet e tyre, duke zhvilluar edhe marrëdhënie shumë më të mira me klientët. Cilësia që prodhojnë projektet e tyre do të jetë shumë më e mirë, që nga ana tjetër, çon në fitime më të mëdha për shoqërinë. Njësi të ndryshme të shoqërisë do të mësojnë se si të koordinohen me njëra-tjetrën, duke realizuar një kthim më të lartë nga investimet, për sasinë e parave të investuara nga firma për zhvillimin e mëtejshëm të punonjësve të tyre.

ICC Academy

Një standard i ri global
për edukimin profesional

RRETH ICC ALBANIA

Komiteti Kombëtar i ICC (International Chamber of Commerce Albania) në Shqipëri u krijua në Tetor 2012, nga disa partnerë themelues ndër të cilat janë Shoqata Shqiptare e Bankave, Boga & Associates, Banka Kombëtare Tregtare dhe Albtelecom & Eagle Mobile. Aktualisht numërojmë rreth 23 anëtarë, nga të cilët 9 banka, 5 studio ligjore, 3 kompani sigurimi, 5 biznese, Unioni i Dhomave, Shoqata e Bankave Shqiptare.

www.icc-albania.org.al

RRETH DHOMËS NDËRKOMBËTARE TË TREGTISË (ICC)

ICC është themeluar në Paris më 1919, si organizata e biznesit botëror, e cila ka si qëllim kryesor shërbimin ndaj biznesit duke promovuar tregtinë dhe investimet, tregjet e hapura për mallra dhe shërbime si dhe qarkullimin e lirë të kapitalit. Sot rrjeti botëror i ICC përfshin mbi 6 milionë shoqëri, dhoma tregtie, shoqata biznesi në më shumë se 130 vende.

www.iccwbo.org

Në një ekonomi globale, të drejtuar nga novacioni dhe dija, edukimi profesional konsiderohet si shtylla e konkurrencës së bizneseve.

Shumë shpesh, shoqëritë e të gjitha përmasave kanë mbetur të sprapsura nga mungesa e zhvillimit të aftësive të fuqisë punëtore.

Akademia e ICC, trajton pikërisht këtë çështje.

Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC), organizata botërore e biznesit, ka prezantuar platformën më të re të trajnimeve elektronike, të quajtur "Akademia e ICC-së", duke vendosur një standard të ri për arsimin profesional.

ÇFARË ËSHTË ICC ACADEMY?

Fillimisht, ICC Academy do të ofrojë një fakultet në banking, duke përfshirë rreth 70 kurse online dhe dy çertifikata globale, në financimin e tregtisë. Kjo gamë e gjerë programesh të specializuara, do ta ngrejë pozicionin e ICC-së si një lider botëror në përcaktimin e rregullave dhe

standardeve tregtare, në mbështetje të tregtisë ndërkombëtare.

SI O FROHEN KURSET E ICC ACADEMY?

ICC Academy ofrohet përmes një platforme dixhitale dinamike, e cila të lejon përdorimin e mjeteve për ndërthurjen e mësimi dixhital dhe projekteve në punë grupi, duke lejuar akademinë të arrijë një numër të lartë pjesëmarrësish nga e gjithë bota.

ICC Academy do të sigurojë arsimim rigoroz, të rëndësishëm dhe zbatueshëm për biznesin, si dhe inkurajon individët për të arritur potencialin e tyre më të lartë, në lidhje me aftësinë profesionale dhe sjelljen etike të biznesit.

SI MUND TË REGJISTROHENI?

Për t'u regjistruar, mjafton të aplikoni përmes hapësirave përkatëse në portalin www.icc.academy. Regjistrimet për kurset do të jenë të aksesueshme në fund të muajit Shtator 2015.

ANËTAR I ASOCIUAR

I hapur për të gjithë profesionistët, pavarësisht punës, industrisë apo përvojës.

Anëtarësimi i Asociuar mundëson njohuri, burime dhe trajnimin që nevojitet për të bërë punën tuaj tani dhe në çdo fazë të karrierës suaj.

Ndërkohë që inkurajohet çdo anëtar të zgjerojë vazhdimisht arsimimin e tyre të biznesit, nuk përbën kusht që çdo anëtar i Asociuar të bëhet anëtar i Çertifikuar i ICC Academy. Çdo person mund t'i bashkohet sipas qëllimeve dhe aspiratave të ndryshme të tij.

NIVELI

Nivel fillestar i hyrjes në ICC Academy

PËRFITIMET

Mundësi lidhjeje me:

- Rrjetet e Komuniteteve Profesionale
- Publikimet ekskluzive dhe informacion
- Rrugët e zhvillimit të karrierës
- Kuota preferenciale anëtarësimi (për trajnime, aktivitete, etj)

ANËTAR I ÇERTIFIKUAR

Ky nivel është i vlefshëm për anëtarët e Asociuar, duke përfshirë studentët, të cilët janë të interesuar në ngritjen e karrierës së tyre në një nivel më të lartë, duke fituar njohuri të përgjithshme dhe bazike në profesionin e tyre.

Gjithnjë e më shumë, bizneset, qeveritë dhe institucionet multilaterale preferojnë të rekrutojnë staf të çertifikuar nga ICC.

NIVELI

Nivel profesional në ICC Academy

PËRFITIMET

Njohja në vendin e punës për nivelin e kompetencës + përfitimet standarde të vlefshme për Anëtarët e Asociuar.

Si të bëheni një anëtar "Full Professional"?

Kaloni Çertifikimin mbi Tregtinë Globale ose 3 vjet Anëtarësim si i Asociuar, duke fituar 30 pikë në vit.

ANËTAR I LARTË

Ky nivel është i hapur për Anëtarët e Çertifikuar të ICC Academy, të cilët besojnë në zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

NIVELI

Kompetencë profesionale e nivelit të avancuar.

PËRFITIMET

Njohja në vendin e punës për nivelin kompetence profesionale të avancuar + përfitimet standarde të vlefshme për Anëtarët e Asociuar.

Si të bëheni një anëtar "Full Senior"?

Kaloni provimin "Certified Trade Finance Professional" ose 5 vjet të njëpasnjëshme Anëtar duke fituar 30 pikë në vit.

FORUMI I II-TË NË SHQIPËRI SWIFT COMPLIANCE

AAB, në bashkëpunim me SWIFT Austria, organizuan Forumin e dytë SWIFT - Compliance Albania. Forumi zhvilloi punimet në datë 5 maj 2015, në mjediset e Sky Hotel në Tiranë dhe u ndoq nga 40 përfaqësues të sistemit bankar në Shqipëri, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë dhe CIS. Ky forum u fokusua në SWIFT KYC dhe sanksionet.



AAB AKTIVITETE

JAVA E INOVACIONIT 2015: "INOVACIONI NË SEKTORIN BANKAR"

Në datë 14 maj 2015, nën kujdesin e Ministres së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, zj. Milena Harito, dhe Governorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në mjediset e Bankës së Shqipërisë u zhvillua veprimtaria me temë: "Inovacioni në sektorin bankar", si një ditë e veçantë, në kuadër të Javës së Inovacionit 2015. Në këtë veprimtari, ku morën pjesë përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, bankave tregtare, institucioneve financiare jobanka etj, u promovuan teknologjitë e reja që sektori bankar përdor në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve për qytetarët shqiptarë.



AAB AKTIVITETE

"BANKAT PËR SHOQËRINË"- SË BASHKU PËR JETËN, SHËNDETIN, MJEDISIN

AAB publikoi për herë të parë një botim special të titulluar: "Raporti CSR 2014 - Bankat për Shoqërinë", i cili u promovua në një ceremoni të mbajtur në Hotel Rogner më 15 qershor. Qëllimi i këtij raporti është të paraqesë disa nga veprimtaritë për arsimin, shëndetësinë, çështjet sociale, mjedisin, artin, kulturën e sportin, të ndërmarra nga bankat gjatë vitit 2014, në kuadër të përgjegjësisë sociale (CSR), duke shpresuar të frymëzojë më shumë të tilla në të ardhmen. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin personalitete të ekonomisë e sistemit bankar, politikës dhe bizneseve, si dhe përfaqësitë e huaja në Shqipëri.



AAB AKTIVITETE

FORUMI I PARË I AUDITORËVE TË BRENDSHËM NË SHQIPËRI

AAB dhe Instituti Shqiptar i Audituesve të Brendshëm (AIIA), organizuan Forumin e Parë të Auditimit të Brendshëm, i cili zhvilloi punimet në mjediset e Hotel Tirana International më 18 qershor 2015. Forumi u fokusua mbi zhvillimin e situatën e profesionit të auditimit të brendshëm në sektorin bankar shqiptarë dhe u ndoq nga auditues të brendshëm dhe drejtues ekzekutivë të bankave, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave, Bankës Qendrore të Kosovës, shoqërive ndërkombëtare të konsulencës etj.



AAB AKTIVITETE



MENAXHIMI STRATEGJIK PËR BURIMET NJERËZORE 1-2 PRILL 2015

Trajnimi u organizua në bashkëpunim me WIFI Albania, për profesionistët e Burimeve Njerëzore, me më tepër se 3 vite përvojë pune. Trajnimi u ndoq nga 10 pjesëmarrës të bankave anëtare dhe u drejtua nga zj. Larisa Winter, eksperte ndërkombëtare për Burimet Njerëzore.



RISTRUKTURIMI I KORPORATËS 21-22 PRILL 2015

Kursi ofroi një pasqyrim të mënyrave të financimit të shoqërive nga ana e bankës, metodat dhe teknikat e përdorura gjatë përbaljes me huatë e shoqërive në vështirësi etj. Trajnimi u organizua në bashkëpunim me WIFI Albania dhe u ndoq nga 10 pjesëmarrës të 4 bankave anëtare.



MENAXHIMI I RREZIKUT 23-24 PRILL 2015

Trajnimi i drejtuar nga z. Udo Scheder, këshilltar financiar me eksperiencë ndërkombëtare, dhe i organizuar në bashkëpunim me WIFI Albania, u ndoq nga 8 pjesëmarrës të 4 bankave anëtare. Në aspektet organizative kursi mbuloi integrimin e menaxhimit të rrezikut të kredisë në organizimin e përgjithshëm të bankës, si dhe trajtoi analizën e disa rasteve studimore të shoqërive të prodhimit, tregtimit dhe turizmit.



SEMINAR MBI LETËR KREDITË 27-28 PRILL 2015

AAB bashkëpunoi me ICC Albania në organizimin e seminarit mbi letër kreditë, i cili u drejtua nga Peter Thiel, Zv. Drejtor në Bankën WZG në Dusseldorf, Gjermani. 10 përfaqësues nga bankat në Shqipëri dhe në Kosovë, si dhe përfaqësues të bizneseve dhe qeverisë morën pjesë në këtë aktivitet.



NEGOCIMI NË SHITJE 7-8 MAJ 2015

AAB mundësoi pjesëmarrjen e 6 përfaqësuesve të bankave anëtare në trajnimin e organizuar nga Lincoln Center. Trajnimi u drejtua nga z. David Turner, trajnues me eksperiencë ndërkombëtare.



SEMINAR MBI GARANCITË BANKARE 14-15 MAJ 2015

AAB bashkëpunoi me ICC Albania në organizimin e Seminarit mbi Garancitë Bankare. Seminarin u drejtua nga Zj. Andrea Hauptmann, Drejtore për Garancitë Bankare pranë Banka Raiffeisen International, dhe Kryetare e Grupit të Punës për Garancitë Bankare pranë ICC-së. Në aktivitet morën pjesë 17 përfaqësues nga bankat në Shqipëri dhe Kosovë si dhe përfaqësues të bizneseve, specialistë të financimit të tregtisë, juristë dhe përfaqësues nga Ministria e Financave.



RREZIKU OPERACIONAL 17-18 QERSHOR 2015

Trajnimi u organizua në bashkëpunim me BACEE dhe morën pjesë 16 pjesëmarrës të bankave anëtare. Rendi i ditës përfshiu fushat kyçe të menaxhimit të cilësorisë së lartë të rrezikut, raportimin e rrezikut dhe përdorimin dhe prezantimin e treguesve të rrezikut, dhe menaxhimin për ekspozimet e mëdha.



SEMINAR PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT 26 QERSHOR 2015

AAB në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) organizoi në mjediset e "Vlora International Hotel" një seminar trajnimi rajonal, për punonjësit e degëve të bankave në jugun e Shqipërisë. Trajnimi u drejtua nga z. Ndue Maluta, nga BKT dhe Zv. Kryetar i Komitetit të AAB për Përpunueshmërinë, z. Agim Ismaili dhe z. Artan Shiqerukaj nga DPPPP-ja.

